



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 151 Akti

Nr. 158 Vendimi
Tiranë, më 29.05.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Pamela Qirko	Kryesuese
Firdes Shuli	Relatore
Etleda Çiftja	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në datën 27 maj 2019 dhe në datën 29 maj 2019, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Dhimitër Lara**, gjyqtar në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Nenet 179/b, A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, të ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatimin dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Dhimitër Lara, proces i cili ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve: të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016 dhe, në përfundim, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Dhimitër Lara është subjekti i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “Ligji nr. 84/2016”), të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Dhimitër Lara, ushtron funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë, që prej vitit 2004. Ky subjekt është shortuar nga Komisioni me shortin e datës 15.5.2018.

3. Me shkresën nr. *** prot., datë 1.2.2018, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. *** prot., datë 15.5.2018, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ka vënë në dispozicion aktin përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Dhimitër Lara (18 fletë).

4. Me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2017, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me nr. *** prot., datë 4.1.2019, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka vënë në dispozicion raportin mbi kontrollin e figurës së deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së, nr. *** , datë 26.12.2018, për subjektin e rivlerësimit, z. Dhimitër Lara (2 fletë).

5. Me shkresën nr. *** prot., datë 25.3.2019, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, me nr. *** prot., datë 11.4.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vënë në dispozicion raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Dhimitër Lara (28 fletë).

6. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka zhvilluar shortin në datën 15.5.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Dhimitër Lara, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët Pamela Qirko, Etleda Çiftja dhe Firdes Shuli. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Firdes Shuli.

7. Me fillimin e procesit të rivlerësimit trupi gjykues administroi:

7.1 aktin për vlerësimin e pasurisë sipas neneve 31 – 33, të ligjit nr. 84/2016, të hartuar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (në vijim “ILDKPKI”);

7.2 raportin e vlerësimit të figurës sipas neneve 34 – 39, të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”);

7.3 raportin e vlerësimit profesional, sipas neneve 40 – 44, të ligjit nr. 84/2016, nga Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGJ”).

8. Me vendimin nr. 1, datë 25.5.2018, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe të rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit, z. Dhimitër Lara, duke përfshirë të tria kriteret: të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Pamela Qirko. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

9. Me vendimin nr. 2, datë 8.5.2019, trupi gjykues vendosi:

9.1 të përfundojë hetimin paraprak administrativ për të tria kriteret e parashikuara në pikën 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016: kriterin e pasurisë, të figurës dhe të aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Dhimitër Lara;

9.2 të miratojë rezultatet paraprake të hetimit;

9.3 të njoftojë subjektin e rivlerësimit se provat e grumbulluara lidhur me vlerësimin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale, kanë nivelin e provueshmërisë sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, duke i kaluar atij barrën e provës mbi rezultatet paraprake të hetimit kryesisht, për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, sipas parashikimeve të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016;

9.4 të njoftojë subjektin e rivlerësimit për të drejtat e tij në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative;

9.5 të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi deklarimin e konfliktit të interesit, të drejtën për t’u njohur me dosjen, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarëve, si dhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar konflikt interesi.

10. Në datën 22.5.2019, subjekti vuri në dispozicion në rrugë elektronike parashitësë me sqarimet e tij dhe dokumente shkresore bashkëngjitur, të cilat i ka nisur në adresën e Komisionit edhe në rrugë postare, arkivuar me nr. ***, datë 22.5.2019.

11. Me vendimin nr. 3, datë 23.5.2019, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Dhimitër Lara, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016, në datën 27.5.2019, ora 12:00, pranë Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve).

12. Sipas nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, më datë 27.5.2019 u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Dhimitër Lara, procesi i rivlerësimit të të cilit u bazua në të tria kriteret, parashikuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit, dhe vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”*.

13. Në datën 29.5.2019, trupi gjykues pasi vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit, deklaroi të mbyllur seancën dëgjimore, në përfundim të së cilës, shpalli vendimin për

konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Dhimitër Lara, sipas parashikimit të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

II. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

II.1. VLERËSIMI I PASURISË

II.1.a Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Nga aktet e ILDKPKI-së rezulton se subjekti ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave privatë për vitet 2003 – 2016 në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”. Në datën 25.01.2017, subjekti ka dorëzuar “Deklaratën e Pasurisë së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”, pranë ILDKPKI-së, në përputhje me nenin 32/1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky institucion ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur sipas neneve 30 – 33, të ligjit nr. 84/2016, dhe me aktin nr. *** prot., datë 1.2.2018, ka konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

II.1.b Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Megjithëse sipas kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Nr. 2/2017^[1] dhe kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizoi një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi për subjektin Dhimitër Lara, i cili nuk u bazua dhe nuk u kushtëzua nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Lidhur me pasuritë e subjektit të rivlerësimit, z. Dhimitër Lara, është kryer një proces i plotë hetimi administrativ, sipas dispozitave ligjore të kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në

^[1] “41.Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

deklarimet e subjektit pranë ILDKPKI-së, provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar pranë Komisionit, çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit sipas nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, si dhe komunikimet me subjektin sipas nenit 46 të këtij ligji dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Hetimi paraprak administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë, konsistoi në:

- i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur;
- ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë;
- iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive;
- iv) evidentimin e deklarimeve të rreme; si dhe
- v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin nëse subjekti ka bërë deklarime të pamjaftueshme për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Hetimi administrativ nga ana e Komisionit, sipas neneve 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016, është kryer në lidhje me pasuritë si vijojnë:

1. Apartament banimi me sip. $66\text{ m}^2 + 25\text{ m}^2$ shtesë anësore në adresën: Rr. “****” (***), p. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë, blerë në çmimin 7.500.000 lekë, në datën 29.7.2006, sipas kontratës me kusht kreditimi nr. ***, nga shtetasit I. M, E. K, H. H dhe M. K.

Burimi i deklaruar i krijimit:

- Shuma prej 3.400.000 lekësh nga shitja e banesës apartament (blerë sipas ligjit për privatizimin e banesave shtetërore të vitit 1993), me sip. 75 m^2 , regjistruar në zk. ***, vol. ***, f. ***, lagjja ***, Rr. “****”, Durrës, prej blerëses B. G, sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 29.8.2006.

- Hua në vlerën 5.000.000 lekë marrë nga “Banka Popullore”, në datën 4.8.2006, me kontratën nr. ***.

Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se:

i) ZVRPP-ja Tiranë¹ konfirmon se, z. Dhimitër A. Lara, ka të regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme pasurinë nr. ***, apartament me sip. 66 m^2 dhe pasurinë nr. *** me sip. 25 m^2 , si dhe ka vënë në dispozicion kontratën e shitblerjes (me kusht kreditimi) nr. ***, datë 29.7.2006. Në kreun III të kësaj kontrate, parashikohet se çmimi i shitjes prej 7.500.000 lekësh është likuiduar në këtë mënyrë: shuma prej 2.550.000 lekësh u likuidua nga blerësi në momentin e hartimit të kësaj kontrate; pjesa tjetër, shuma prej 4.950.000 lekësh, do të paguhet me kredi nëpërmjet “Bankës Popullore”.

ii) OSHEE-ja² konfirmon në emër të subjektit Dhimitër Lara kontratën ***, në instancën Tiranë, me adresë në Rr. “****”.

Kjo pasuri është deklaruar nga ana e subjektit, si vijon:

¹ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 12.10.2018, të ZVRPP-së Tiranë, në dosjen e Komisionit.

² Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 25.3.2019, të OSHEE-së në dosjen e Komisionit.

1.1 Në deklarinimin për vitin 2006 është deklaruar *shtuar apartament në Tiranë*, me vlerë 7.500.000 lekë. **Nuk është deklaruar burimi i krijimit.**

Lidhur me mosdeklarimin e burimit të krijimit të pasurisë në deklaratën për vitin 2006, me kalimin e barrës së provës, subjektit i është kërkuar të japë sqarime. Në parashtrimet e datës 22.5.2019, subjekti ka pretenduar se ky konstatim nuk qëndron, duke deklaruar: “... në deklaratën e vitit 2007, në kolonat detyruese për t’u përmbushur, në mënyrë të shprehur, nuk parashikohet se duhet të deklarohet burimi i krijimit të pasurisë së shtuar...”. Veç kësaj subjekti pretendon se në këtë deklaratë janë deklaruar të dyja pasuritë që kanë shërbyer si burim krijimi si vijon: (i) pakësim apartamenti në Durrës; dhe (ii) kredi e marrë nga “Banka Popullore” dhe, për rrjedhojë, është deklaruar burimi i krijimit të këtij apartamenti.

Është e vërtetë që në kolonën përkatëse “*përshkrimi i pasurisë*” (shtesa dhe pakësime), nuk përmendet shprehimisht që subjekti duhet të deklarojë burimin e shtimeve të pasurive të çdo lloji, por në informacionin e dhënë në ndihmë të subjekteve deklaruese, për zbatimin sa më korrekt të detyrimeve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, është shprehur se në deklarinimin periodik vjetor duhet të pasqyrohet edhe burimi i shtimit të pasurive.

Për këtë arsye, deklarimi për vitin 2006 është i pasaktë për shkak të mosdeklarimit të burimit të pasurisë. Por, duke marrë në konsideratë: (i) faktin që në deklarinimin periodik për këtë vit, subjekti ka deklaruar si pakësim pasurie shitjen e një apartamenti në Durrës, nga i cili ka përfituar shumën prej 3.400.00 lekësh; (ii) faktin që në rubrikën “*detyrime financiare*”, subjekti ka deklaruar kredi afatgjatë në vlerën prej 5.000.000 lekësh për blerje apartamenti në Tiranë, sip. 66+37 m² (i cili është apartamenti objekt shqyrtimi) në adresën: Lagjja nr. ***, Rr. “***”, p. ***, ap. ***; si dhe (iii) faktin që të dyja këto veprime juridike janë deklaruar si burim krijimi i pasurisë në deklaratën “*Vetting*”, Komisioni çmoi se kjo pasaktësi nuk ka sjellë asnjë pasojë dhe, si e tillë, nuk është mbajtur në konsideratë gjatë vlerësimit përfundimtar të çështjes.

1.2 Në deklaratën “*Vetting*” subjekti ka deklaruar si burim krijimi të pasurisë:

1.2.a Hua në shumën prej 5.000.000 lekësh marrë nga “Banka Popullore” me kontratën nr. ***, datë 4.8.2006.

Pas verifikimeve, u vërtetua përdorimi i huasë si burim krijimi i pasurisë, si vijon:

i) Z. Dhimitër Lara dhe znj. B. L, në cilësinë e huamarrësve me kontratën për hua afatgjatë nr. ***, datë 4.8.2006, kanë marrë nga “Banka Popullore” hua në shumën prej 5.000.000 lekësh për blerje apartamenti për 15 vjet, me interes 5 % në vit. Si garanci për shlyerjen e kësaj huaje janë vënë pasuritë me nr. *** dhe nr. ***, blerë në datën 29.7.2006, sipas kontratës me kusht kreditimi nr. ***, nga subjekti dhe bashkëshortja e tij.

ii) Nga gjendja e llogarisë, vënë në dispozicion nga “Societe Generale Albania”³, rezulton se në datën 15.8.2006 është disbursuar kredia në vlerën prej 5.000.000 lekësh për llogari të z. Dhimitër Lara dhe znj. B. L dhe, në po këtë datë, kjo shumë ka kaluar nga llogaria e tyre në llogarinë e znj. H. K, një nga shitëset e pasurisë, me përshkrimin *blerje apartamenti*.

³ Shihni gjendjen llogarisë nga “Societe Generale Albania”, në Aneksin ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

iii) Huaja me vlerë prej 5.000.000 lekësh marrë nga “Banka Popullore” është shlyer tërësisht prej subjektit me të ardhura të ligjshme të pasqyruara në tabelën më poshtë:

Pershkrimi\VITET	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	TOTAL
Disbursuar kredi nga Banka Popullore dt 15/08/2006	5.000.000								
Shlyerje principali	-141.056	-434.052	-467.680	-479.930	-2.189.615	-169.586	-168.404	-949.678	-5.000.000
Shlyerje interesa	-87.268	-268.540	-289.345	-296.924	-1.354.675	-104.920	-104.188	-587.549	-3.093.409
Shlyerje total	-228.324	-702.592	-757.025	-776.854	-3.544.290	-274.505	-272.592	-1.537.227	-8.093.409

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, nuk u konstatuan problematika dhe dyshime në lidhje me burimin e deklaruar “hua në vlerën 5.000.000 lekë nga Banka Popullore”, si dhe u vërtetua se deklaramet e subjektit janë të sakta dhe përputhen plotësisht me dokumentet e administruara gjatë hetimit administrativ.

1.2.b Shitjen e banesës së apartamentit (blerë sipas ligjit për privatizimin e banesave shtetërore të vitit 1993), me sip. 75 m², regjistruar në zk. ***, vol. ***, f. ***, lagjja ***, Rr. “***”, Durrës, blerëses B. G, sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 29.8.2006.

Lidhur me këtë pasuri dhe me origjinën e krijimit të saj, gjatë hetimit administrativ u konstatua se:

i) Me kontratën e shitblerjes të datës 16.5.1994, shtetasit Dhimitër Lara dhe S. e B. L kanë blerë këtë apartament nga Ndërmarrja Komunale Banesa me çmim 20.585 lekë.

ii) Pasuria me nr. *** është regjistruar në ZVRPP-në Durrës⁴ në emër të subjektit, nënës dhe bashkëshortes së tij.

iii) Subjekti dhe personat e lidhur, me kontratë shitjeje me rezervë nr. ***, datë 29.8.2006⁵, i kanë shitur këtë pasuri blerëses B. G, në shumën 3.400.000 lekë, kësti i parë i të cilit prej 2.800.000 lekësh është marrë dorazi jashtë zyrës noteriale në ditën e lidhjes së kontratës në datën 29.8.2006 dhe kësti i dytë prej 600.000 lekësh është paguar në datën 16.9.2006, sipas deklaratës noteriale nr. ***.⁶

iv) Me kartelën e pasurisë⁷ vërtetohet se në datën 14.11.2006, kjo pasuri është regjistruar në emër të shtetasës B. G.

Nga sa më sipër rezultoi e vërtetuar se:

i) Pasuria apartament banimi ndodhur në Durrës, është përfituar ligjërisht prej subjektit të rivlerësimit, sipas ligjit për privatizimin e banesave shtetërore nr. ***, datë 23.12.1992 dhe, po në rrugë ligjore, pronësia mbi këtë apartament i ka kaluar shtetasës B. G.

ii) Kësti i parë prej 2.800.000 lekësh i paguar nga kjo shtetase është marrë dorazi nga subjekti jashtë zyrës noteriale, ditën e lidhjes së kontratës, në datën 29.8.2006.

Pra, në momentin e blerjes së pasurisë në Tiranë në datën 29.7.2006, subjekti nuk e ka pasur shumën prej 2.550.000 lekësh të përfituar nga shitja e pasurisë në Durrës në datën 29.8.2006.

⁴ Shihni certifikatën për vërtetim pronësie të datës 28.8.2006, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵ Shihni dokumentet e vëna në dispozicion nga subjekti, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶ Shihni dokumentet bashkangjitur shkresës nr. ***, datë 6.11.2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷ Shihni shkresën nr. ***, datë 6.11.2017, të ZQRPP-së, në dosjen e ILDKPKI-së.

Pasi iu kërkuan sqarime lidhur me këtë fakt, në përgjigje të pyetësorëve 2 dhe 3, subjekti ka sqaruar se shuma prej 2.250.000 lekësh, është paguar nga ana e tij në momentin e lidhjes së kontratës nr. ***, datë 29.7.2006, për blerjen e apartamentit në Tiranë sipas parashikimit në kontratë. Gjithashtu, ka sqaruar në lidhje me përfitimin e kësaj shume, si vijon:

- Në datën 24.7.2006, tri ditë para lidhjes së kontratës (29.7.2006), subjekti ka tërhequr cash nga llogaria e tij në "Raiffeisen Bank" shumën prej 1.200.000 lekësh, dhe ka vënë në dispozicion dokumentin nxjerrje llogarie nga kjo bankë⁸, i cili vërteton këtë fakt.

- Shuma prej 1.350.000 lekësh është marrë cash nga ana e bashkëshortes së subjektit, znj. B. L, prej motrës së saj, znj. A. B (S.)⁹, të cilën ia ka kthyer dorazi në datën 29.8.2006, pasi përfitoi të ardhura nga shitja e banesës në Durrës. Lidhur me burimin e krijimit me të ardhura të ligjshme të znj. A. B. S, subjekti ka paraqitur shkresën nr. *** prot., datë 16.4.2019, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë,¹⁰ e cila konfirmon të ardhurat/qarkullim të personit fizik që ajo përfaqëson për periudhën 2003 – 2006.

- Pra, është paguar gjithsej shuma prej 2.250.000 lekësh.

Në përfundim të hetimeve paraprake, lidhur me pasurinë apartament banimi, me sip. 66 m² + 25 m² shtesë anësore në adresën: Rr. "****" (***), p. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, Tiranë, bazuar në nenin 52, të ligjit nr. 84/2016, dhe paragrafit 5, të nenit Ç, të Aneksit të Kushtetutës, subjektit i ka kaluar barra e provës për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën në lidhje me konstatimet si vijojnë:

i) Ka mospërputhje të deklaratës "Vetting" me deklaratimet gjatë procesit të rivlerësimit lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, pasi, në deklaratën "Vetting" janë deklaruar të ardhura nga shitja e apartamentit në Durrës (ndërkohë që kjo pasuri është shitur një muaj më vonë nga dita e blerjes së pasurisë), ndërsa në deklaratimet gjatë procesit të rivlerësimit është deklaruar se për pagimin e kësaj të parë të blerjes së pasurisë në shumën prej 2.550.000 lekësh, janë përdorur një llogari bankare e subjektit pranë "Raiffeisen Bank" për shumën 1.200.000 lekë, si dhe shuma prej 1.350.000 lekësh e marrë prej znj. A. B. S.

ii) Nuk vërtetohet fitimi i realizuar nga personi i lidhur, znj. A. B. S., me qëllim vërtetimin e të ardhurave të ligjshme të saj të mjaftueshme për dhënien e shumës prej 1.350.000 lekësh.

Subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës, në parashtrimet e tij të datës 22.5.2019:

i) Nuk është shprehur në lidhje me mospërputhjen në deklarimin e burimit të krijimit të shumës prej 2.550.000 lekësh në deklaratën "Vetting" me deklaratimet gjatë procesit të rivlerësimit. Për këtë arsye, në lidhje me këtë mospërputhje ai u pyet në seancë dëgjimore në datën 27.5.2019.

Në përgjigje të pyetjes, subjekti deklaroi se, në deklaratën e përgjithshme të çdo viti subjektet duhet të deklaronin ato veprime që kalonin dhe në vitin tjetër. Ai nuk ishte i detyruar të deklaronte shumën në lekë që i mori znj. A. B, të cilën ia ktheu pas një muaji me shitjen e pasurisë në Durrës. Sipas tij, burimi i krijimit të pasurisë në Tiranë është shitja e apartamentit

⁸ Shihni dokumentet bashkangjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

⁹ Emri i kësaj shtetaseje është A. B. S, vërtetuar me çdo dokument zyrtar që i referohet kësaj shtetaseje, përmendur në këtë vendim. Subjekti i rivlerësimit, në çdo rast është shprehur A. B. S. Nga të gjitha aktet, vërtetohet se është i njëjti person.

¹⁰ Shihni dokumentet bashkangjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3 në dosjen e Komisionit.

në Durrës, ndërsa në lidhje me huat e përkohshme, ligji nuk kërkon t'i deklarosh ato brenda vitit.

ii) Në lidhje me fitimin e realizuar nga aktiviteti privat i znj. A. B. S, ashtu si dhe në përgjigjet e dhëna gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka deklaruar: “ ... znj. A. B. S, në mënyrë të ligjshme nga aktiviteti i saj tregtar i regjistruar si person fizik me ***, ka pasur mjaftueshëm aftësi financiare për të më huazuar për një muaj shumë prej 1.350.000 lekësh...” dhe ka vënë sërish në dispozicion vërtetimin nr. ***, datë 16.4.2019, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë.

Analizë ligjore

Lidhur me pretendimet e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, për mënyrës se si e ka siguruar shumë prej 2.250.000 lekësh, një pjesë e çmimit të blerjes së apartamentit në Tiranë, Komisioni vlerësoi se ato janë të bazuara pasi:

A. U vërtetua se për pagimin e shumës prej 1.200.000 lekësh është përdorur një depozitë bankare (llogari page) e subjektit në “Raiffeisen Bank”, e cila ka konfirmuar se në datën 24.7.2006 (pesë ditë para lidhjes së kontratës), subjekti e ka tërhequr *cash* këtë shumë nga llogaria e tij me nr. ***.¹¹

Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të shumës prej 1.200.000 lekësh:

Komisioni kreu analizën financiare si në tabelën më poshtë, bazuar në deklaratat e subjektit dhe dokumentet e administruara, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për kursimin e shumës 1.200.000 lekësh deri në datën 24.7.2006, kur ka bërë tërheqjen.

Gjendja në datën 31.12.2005	557.063
Të ardhura/subjekti/ periudha 1.1.2006 – 24.7.2006	890.540
Të ardhura/ bashkëshortja e subjektit/ periudha 1.1.2006 – 30.6.2006	103.920
Tërhequr në datën 24.7.2006	-1.200.000
Shpenzime jetese	-255.633
DIFERENCA	95.889

B. Shuma prej 1.350.000 lekësh i është marrë hua motrës së bashkëshortes, znj. A. B. S, shumë e cila i është kthyer një muaj më vonë, pasi janë përfituar të ardhura nga shitja e apartamentit në Durrës.

Edhe pse nuk ka një dokument shkresor apo transfertë bankare e cila të vërtetojë marrëdhënien e huas për një afat prej një muaji midis dy motrave, Komisioni vlerësoi ta marrë në konsideratë këtë pretendim të subjektit, nisur nga faktet si vijojnë:

i) Nga certifikata familjare me nr. serie ***, lëshuar në datën 4.3.2019 nga Zyra e Gjendjes Civile të Rrethit Krujë¹², rezultoi e vërtetuar se znj. A. B. S. është motra e bashkëshortes së subjektit, znj. B. L. S.

¹¹ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 17.9.2018, të “Raiffeisen Bank”, e cila konfirmon tërheqjen nga llogaria e pagës së z. Dhimitër Lara, në datën 24.7.2006, në shumë prej 1.200.000 lekësh.

¹² Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

ii) Kodi Civil në dispozitat mbi huan (neni 801 e në vijim) nuk kërkon domosdoshmërisht dhënien e huas me një akt shkresor të thjeshtë apo noterial.

iii) Nuk ka pasur dhe nuk ka detyrim ligjor për kalimin e shumave në rrugë bankare midis dy individëve.

iv) Nisur nga realiteti shqiptar i viteve 2000 (por dhe sot), marrëdhënia e huas midis dy motrave, dhe për një periudhë të shkurtër kohore, në kushtet kur subjektit i duhej të lidhte një kontratë shitjeje për blerjen e një pasurie, me qëllim vënien e saj si garanci hipotekore për marrjen e një kredie në datën 04.8.2006 (gjashtë ditë pasi është bërë blerja e pasurisë), Komisioni vlerëson se, këto rrethana e bëjnë të besueshëm pretendimin e subjektit që shuma prej 1.350.000 lekësh i është marrë hua znj. A. B. S.

v) Duke qenë se veprimi i marrjes dhe i kthimit të huas është bërë brenda vitit financiar të deklaramit (viti 2006), subjekti nuk ka pasur detyrim ligjor deklarimin e huas dhe shlyerjen e saj.

vi) Nga verifikimi *online* i faqes së QKB-së dhe vërtetimi nr. *** prot., datë 16.4.2019, i lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, vërtetohet se znj. A. B. S. ka pasur të ardhura nga aktiviteti si person fizik.

vii) Në datën 29.8.2006, subjekti ka përfituar të ardhura nga shitja e apartamentit në Durrës, fakt që tregon mundësinë financiare të tij për t'ia kthyer znj. A. B. S. shumën prej 1.350.000 lekësh.

viii) Pasi ka shitur apartamentin në Durrës, në deklaramet e viteve pasardhëse, nuk rezulton që subjekti të ketë gjendje likuiditetesh. Ky fakt është në favor të pretendimit të subjektit se për shlyerjen e huas ndaj znj. A. B. S. ka përdorur të ardhura të përfituara nga shitja e kësaj pasurie.

Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të znj. A. B. S., si person i lidhur:

Me kalimin e barrës së provës, subjektit i është kërkuar të vërtetojë fitimin e realizuar nga znj. A. B. (S.) me qëllim vërtetimin e të ardhurave të ligjshme të saj për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, të mjaftueshme për dhënien e shumës prej 1.350.000 lekësh, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 31, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Në parashtrimet e tij të datës 22.5.2019, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se znj. A. B. S. ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme nga aktiviteti si person fizik, për të cilat ka paguar detyrimet ligjore, bazuar në shkresën nr. *** prot., datë 16.4.2019, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, nga ku rezultoi e vërtetuar se:

i) Znj. A. B është person fizik me NIPT ***, regjistruar në organin tatimor në datën 30.6.2003 me aktivitet që ka për objekt *tregti me pakicë artikujsh ushqimorë etj.*, dhe është çregjistruar në datën 16.5.2011.

ii) Për periudhën 2003 – 2006, personi fizik ka pasur të ardhura (qarkullim) për të cilin është paguar tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, si në tabelën më poshtë:

Viti	Qarkullim	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin
2003	1.600.000	-64.000
2004	2.500.000	-100.000
2005	2.333.333	-66.164
2006	2.666.666	-40.000
	9.099.999	-270.164

iii) Për periudhat e mësipërme subjekti ka deklaruar vetëm të ardhura, pasi subjektet me tatim të thjeshtuar nuk kanë detyrim të paraqesin në organin tatimor pasqyra të ardhura dhe shpenzime, pra, nuk nxjerrin rezultat financiar dhe nuk shpërndajnë dividend, sipas UMF-së nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, dhe pikave 5 dhe 6 të “vendimit për destinimin e fitimit”. Subjekti nuk ka detyrim të depozitohet pranë administratës tatimore vendimin e organit kompetent vendimmarrës të shoqërisë lidhur me rezultatet financiare të vitit pasardhës dhe destinimin e fitimit pas tatimit, pasi është biznes i vogël me përgjegjësi tatimore për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin.

Nga përmbajtja e këtij vërtetimi konstatohet se subjekti është në pamundësi objektive për të vërtetuar fitimin *neto* të biznesit të znj. A. B. S. në momentin e dhënies së huas. Nisur nga të dhënat që disponon, Komisioni, gjithashtu, është në pamundësi për të llogaritur këtë fitim.

Bazuar në pikën 2, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni vlerësoi se mosparaqitja nga ana e subjektit e një dokumenti për të vërtetuar fitimin *neto* të aktivitetit të biznesit *person fizik*, “A. B. S.”, është për shkaqe të arsyeshme. Për rrjedhojë, nisur nga fakti se për periudhën 2003 – 2006, ky subjekt tregtar ka pasur qarkullim total për të cilin është paguar tatimi i thjeshtuar mbi fitimin në shumën prej 9.099.999 lekësh (për vitin 2006 ky qarkullim, i cili ka tendencë në rritje, ka qenë në shumën 2.666.666 lekë), si dhe nisur nga fakti që dhënia e huas është bërë vetëm për një afat njëmuajor, Komisioni krijoi bindjen se znj. A. B. S., ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për dhënien e huas prej 1.350.000 lekësh në datën 29.7.2006, duke e konsideruar të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit.

Lidhur me mospërputhjen pjesërisht të deklaratës “Vetting” me deklaratimet gjatë procesit të rivlerësimit:

Komisioni çmoi se deklarimi i burimit të krijimit të pasurisë apartament banimi në Tiranë në deklaratën “Vetting” është pjesërisht i pasaktë për shkak se si burim fitimi i shumës prej 2.550.000 lekësh janë deklaruar të ardhura nga shitja e apartamentit në Durrës, ndërkohë që kjo pasuri është shitur një muaj më vonë nga dita e lidhjes së kontratës për blerjen e pasurisë.

Lidhur me këtë konstatim, Komisioni vlerësoi se subjekti është treguar i pakujdesshëm në plotësimin e deklaratës “Vetting” dhe se pasaktësia në deklarim është një pasaktësi formale, me arsyetimin se:

i) Në kushtet kur shuma prej 1.200.000 lekësh disponohej ligjërisht nga subjekti dhe është tërhequr realisht nga llogaria e tij e pagës pranë “Raiffeisen Bank” në datën 24.7.2006 (pesë ditë përpara lidhjes së kontratës së shitjes, datë 29.7.2006), nuk ka pasur asnjë arsye që subjekti të mos e deklaronte (të fshihte) faktin që kjo shumë është përdorur për pagimin e një pjese të kështit të parë prej 2.550.000 lekësh për blerjen e pasurisë në Tiranë.

ii) Shitja e apartamentit në Durrës një muaj pasi ishte lidhur kontrata e blerjes së apartamentit në Tiranë ka shërbyer si burim për kthimin e huas prej 1.350.000 lekësh znj. A. B. S. (arsyetuar

si më sipër) dhe logjikisht ka shërbyer si burim faktik për likuidimin e kësaj pjese të çmimit të blerjes së apartamentit në Tiranë.

Në vlerësimin tërësor të rrethanave, Komisioni nuk sheh asnjë arsye të qëllimshme për mosdhënien e shpjegimeve përkatëse gjatë plotësimit të deklaratës “Vetting”, ashtu sikurse subjekti ka dhënë gjatë procesit të rivlerësimit, për fakte të cilat kanë ndodhur realisht dhe, si të tilla, nuk mund dhe nuk ka pasur arsye të fshiheshin prej tij.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, bazuar në të gjitha faktet dhe provat e përmendura më sipër, Komisioni krijoi bindjen se deklarimi pjesërisht i pasaktë në deklaratën “Vetting”, lidhur me burimin faktik që ka shërbyer për pagesën e shumës prej 2.550.000 lekësh, si këst i parë për blerjen e apartamentit në Tiranë, është një pasaktësi që nuk ka sjellë asnjë pasojë juridike dhe, si e tillë, nuk është konsideruar shkak për shkarkimin e subjektit nga detyra gjatë procesit përfundimtar të vendimmarrjes.

Për të arritur në këtë përfundim Komisioni iu referua në mënyrë të përmbledhur fakteve si vijojnë:

i) Realisht subjekti ka përfituar të ardhura nga shitja e një apartamenti në Durrës, një pjesë të të cilave i ka përdorur, ndonëse jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, për pagimin e një pjese të çmimit të blerjes së apartamentit në Tiranë. Komisioni nuk sheh arsye që subjekti, me paramendim, të ketë deklaruar si burim krijimi të shumës prej 2.250.000 lekësh, të ardhura të përfituara nga shitja e pasurisë në Durrës, shitje për të cilën, ka qenë plotësisht i ndërgjegjshëm se është bërë një muaj pasi kishte paguar këtë shumë dhe datën e shitjes së të cilës, e ka deklaruar saktësisht në deklaratën “Vetting”.

ii) U vërtetua burimi i ligjshëm i krijimit të shumës prej 1.200.000 lekësh në llogari bankare në “Raiffeisen Bank” në emër të subjektit dhe, si rrjedhim, kjo shumë është konsideruar si e ardhur e ligjshme gjatë analizës financiare. Duke qenë një llogari me të ardhurat nga paga, nuk ka pasur asnjë arsye që subjekti të fshihte përdorimin e saj me qëllim pagimin e një pjese të çmimit të blerjes së pasurisë.

iii) U vërtetua mundësia financiare me të ardhura të ligjshme e znj. A. B. S. për dhënien e huas prej 1.350.000 lekësh, për një afat prej një muaji; si rrjedhim kjo shumë është konsideruar si e ardhur e ligjshme gjatë analizës financiare. Përveç kësaj, nuk ka asnjë provë ose rrethanë, të marrë nga cilido burim i ligjshëm, që të vërtetojë të kundërtën e këtij konstatimi dhe, si rrjedhim, faktin që subjekti e ka përfituar shumën prej 1.350.000 lekësh në mënyrë të paligjshme.

Lidhur me mundësinë financiare të subjektit për blerjen e pasurisë apartament banimi me sip. 66 m² + 25 m² shtesë anësore, në Tiranë, përkatësisht pasuritë nr. *** dhe nr. ***:

Nga analiza financiare, dhënë në tabelën më poshtë, rezultoi se subjekti ka pasur mundësi financiare në momentin e blerjes së pasurisë (korrik 2006), për të justifikuar me të ardhura të ligjshme blerjen e pasurisë, si dhe shpenzimet e tjera të kryera deri në momentin e blerjes.

Përshkrimi		Lekë
1	PASURI	7.500.000
	Apartament: Rr. “***”, sip. 66+37 m ²	7.500.000
2	DETYRIME	6.350.000
	Kredi bankare nga “Banka Popullore”	5.000.000
	Hua nga znj. A. S.	1.350.000
3	PASURI NETO (1-2)	1.150.000
4	TË ARDHURA	994.460
	Të ardhura/ subjekti/periudha 1.1.2006 – 24.7.2006	890.540
	Të ardhura/ bashkëshortja e subjektit/periudha 1.1.2006 – 30.6.2006	103.920
5	SHPENZIME	255.633
	Shpenzime jetese	255.633
6	Gjendja e likuiditeteve në datën 31.12.2005	557.063
	TOTAL (4-3-5+6)	145.889

2. Depozitë rekord 7 vjet bankare (3 të tilla) në llogarinë bankare me nr. ***, pranë BKT-së. Vlera 19.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %.

Burimi i deklaruar i shumës prej 19.000.000 lekësh: Transferuar nga nr. llogarisë *** “Raiffeisen Bank”, në të cilën në datën 4.6.2013 është transferuar shuma prej 21.600.000 lekësh nga nr. i llogarisë *** pranë “American Bank of Investments”. Gjithashtu, në deklaratën “Vetting” subjekti ka dhënë shpjegime të hollësishme mbi burimin e krijimit të kësaj shume, nga të ardhura të përfituara për shkak të kompensimit nga shpronësimi i një pasurie të paluajtshme, ku ai dhe nëna e tij kanë qenë bashkëpronare.

2.1 Në lidhje me kalimin e kësaj shume në llogari të subjektit

Me qëllim verifikimin e mënyrës së kalimit të kësaj shume në llogari të subjektit nga Komisioni u kërkuar dhe u administrua informacion i hollësishëm nga “Banka Amerikane e Investimeve”, “Raiffeisen Bank” dhe “BKT”-së, sipas të cilit u vërtetua se deklaratimet e subjektit në lidhje me origjinën dhe mënyrën e kalimit të shumave përkatëse në llogarinë e tij, janë të sakta.

Konkretisht:

i) “Banka Amerikane e Investimeve”¹³ (ish-“Credit Agricole Bank”) ka informuar se në emër të trashëgimtarëve të familjes Lara, ka pasur një llogari shumëvjeçore me nr. ***, e cila është përdorur për kalimin nga Autoriteti Portual Durrës, të shumës prej 108.000.000 lekësh. Kjo shumë përputhet me shumën e deklaruar nga subjekti në deklaratimin periodik për vitin 2012, si shumë e përfituar nga subjekti, nëna e tij dhe trashëgimtarë të tjerë të grupit të dytë, sipas VKM-së nr. 855, datë 13.12.2006, dhe vendimit të formës së prerë nr. ***, datë 17.2.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (trajtuar më poshtë). Kjo llogari është mbyllur në datën 3.6.2018.

ii) “Raiffeisen Bank”¹⁴ ka informuar se në datën 4.6.2013 nga “Banka Amerikane e Investimeve”, ka kaluar në llogarinë e pagës me nr. ***, të z. Dhimitër Lara, shuma prej 21.600.000 lekësh, deklaruar në deklaratën periodike për vitin 2013, si pjesë e bashkëpronësisë

¹³ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 26.9.2018, nga “Banka Amerikane e Investimeve” në dosjen e Komisionit.

¹⁴ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 17.9.2018 nga “Raiffeisen Bank” në dosjen e Komisionit.

së subjektit dhe nënës së tij. Në datën 7.6.2013, nga kjo shumë pjesa prej 1.425.313 lekësh ka kaluar nga “Raiffeisen Bank” te “Societe Generale” për shlyerje të parakohshme kredie (prej 5.000.000 lekësh) dhe shuma prej 19.000.000 lekësh ka kaluar pranë “BKT”-së.

iii) “BKT”-ja¹⁵ ka informuar se në datën 7.6.2013 shuma prej 19.000.000 lekësh ka kaluar nga llogaria e subjektit në “Raiffeisen Bank”, në llogarinë e tij me nr. ***, pranë “BKT”-së.

iv) “BKT”-ja¹⁶ ka konfirmuar në emër të subjektit, z. Dhimitër Lara, llogarinë *** me gjendje 19.743.489 lekë, në datën 25.1.2017, prej të cilave:

- shuma prej 743.489 lekësh është e lirë në llogari rrjedhëse, e cila ka burim interesin bankar në shumën 974.700 lekë (deklaruar në deklaratën “Vetting” nga subjekti, trajtuar më poshtë);
- shuma prej 12.000.000 lekësh është e investuar në depozitë me afat 7 vjet, me datë maturimi 24.6.2021;
- shuma prej 5.000.000 lekësh është e investuar në depozitë me afat 7 vjet, me datë maturimi 3.11.2021;
- shuma prej 2.000.000 lekësh është e investuar në depozitë me afat 7 vjet, me datë maturimi 16.1.2022.

Në përfundim të procesit, nuk ka pasur asnjë paqartësi apo dyshim në lidhje me krijimin e depozitës rekord me afat shtatëvjeçar në “BKT”, në shumën prej 19.000.000 lekësh.

2.2 Lidhur me origjinën e burimit të ligjshëm për krijimin e kësaj depozite

Me qëllim verifikimin e burimit të ligjshëm të depozitës dhe faktit nëse subjekti është favorizuar në përfitimin e kësaj depozite, janë kryer disa veprime hetimore, në përfundim të të cilave, ka rezultuar se burimi i krijimit të depozitës në shumën 19.000.000 lekë, janë të ardhura të përfituara ligjërisht prej subjektit dhe se deklaratimet e tij përputhen plotësisht me dokumentet e administruara.

Nga verifikimi i të gjitha provave të grumbulluara, gjatë hetimit administrativ rezultoi se:

2.2.a Me vërtetimin e pronësisë së datës 9.4.1997¹⁷ të hipotekës Durrës, vërtetohet se shtetasit R. L., K. L., V. L., V. L., S. L. e Dhimitër Lara janë bashkëpronarë të një trualli me sip. 3600 m² (ndodhur te ***, Durrës), përfituar në bazë të vendimit nr. ***, datë 23.11.1996, të KKKP-së ish-pronarëve dhe vendimit nr. ***, datë 13.2.1997, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, si trashëgimtarë të z. Dhimitër Lara (gjyshi i subjektit, i cili e ka fituar pronësinë me aktin publik nr. ***, datë 24.6.1940, i shtetëzuar në vitin 1946.)

2.2.b Me vendimin nr. 855, datë 13.12.2006, të KM-së, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimi i infrastrukturës portuale në portin e Durrësit”, u vendos: “... të gjithë pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në vlerë të plotë për sipërfaqen 7.303 m², tokë truall, e vlerësuar me 3.000 lekë për m², në shumën e përgjithshme 21.909.000 lekë, e cila do të përballohet nga të ardhurat e Autoritetit Portual, Durrës”.

¹⁵ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 28.9.2018 nga “BKT”-ja në dosjen e Komisionit.

¹⁶ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 1.10.2018 nga “BKT”-ja në dosjen e Komisionit.

¹⁷ Shihni vërtetim pronësie, datë 9.4.1997, dhe vërtetim pronësie, datë 16.1.1992, lëshuar nga Hipoteka Durrës në dosjen e ILDKPKI-së.

Sipas kësaj VKM-je, nga lista e pronarëve që do të shpronësohen për shkak të ndërtimit të infrastrukturës portuale në Portin e Durrësit, rezulton se: (i) bashkëpronarët K. Q., S. Q., M. Q., M. K., S. K., V. K., N. K., A. V., për pasuritë nr. *** dhe nr. ***, zk. ***, me sip. 3.703 m², do të shpronësohen në shumën 11.109.000 lekë (me vlerë 3.000 lekë/m²); (ii) bashkëpronarët R. L., K. L., V. L., V. L., S. L. e Dhimitër Lara, për pasurinë nr. ***, zk. ***, për sip. 3.600 m², do të shpronësohen në shumën 10.800.000 lekë (me vlerë 3.000 lekë/m²).

2.2.c Masa e kompensimit prej 3.000 lekësh për m² është bërë objekt gjykimi me kërkesë të bashkëpronarëve të shpronësuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me vendimin e formës së prerë nr. ***, datë 17.2.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁸ ka ndryshuar VKM-në nr. 855, datë 13.12.2006, lidhur me vlerën e shpronësimit të pronës së paditësve, duke e çuar këtë vlerë nga 3.000 lekë për m² në 30.000 lekë për m². Në total, masa e shpërblimit për bashkëpronarët e grupit të dytë, ku bëjnë pjesë subjekti dhe nëna e tij, ndryshoi nga vlera 10.800.000 lekë në vlerën 108.000.000 lekë.

Me qëllim evidentimin e faktit nëse vendimi i sipërcituar i gjykatës është marrë duke favorizuar paditësit, për shkak të pozicionit si gjyqtar të subjektit të rivlerësimit, janë kryer disa veprime verifikuese në lidhje me procedurat ligjore të ndjekura, nga ku ka rezultuar se:

i) Pas vënies në dijeni të aktit administrativ të sipërcituar (VKM-ja nr. 855) paditësit në gjykim (të gjithë bashkëpronarët e sip. 7.303 m²) në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të nenit 24, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, paraqitën ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë lidhur me masën e shpërblimit të caktuar në VKM-në, duke kërkuar ndryshimin e kësaj të fundit nga 3.000 lekë për m² në 108.036 lekë për m².

ii) Me vendimin nr. ***, datë 14.12.2007, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë për ndryshimin e masës së shpërblimit si më sipër, si të pambështetur në prova.

iii) Kundër këtij vendimi është ushtruar ankim nga ana e palës paditëse në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila me vendimin nr. ***, datë 20.10.2009, ka vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 14.12.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë me një tjetër trup gjykues.

iv) Pasi çështja u shqyrtua nga një tjetër trup gjykues, me vendimin nr. ***, datë 17.2.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, u pranua pjesërisht padia, pasi paditësit kishin kërkuar që masa e shpërblimit të ishte 108.036 lekë/m², ndërkohë që gjykata ka vendosur që masa e shpërblimit për m² të ndryshojë nga 3.000 lekë/m² në 30.000 lekë/m².

v) Me vendimin nr. ***, datë 28.02.2013, Gjykata e Apelit Tiranë, vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 17.2.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vendimi ka marrë formë të prerë.

Nga të gjitha faktet si më sipër, rezultoi se, subjekti, nëna e tij dhe bashkëpronarët e tjerë të shpronësuar, kanë kërkuar në rrugë ligjore ndryshimin e masës së shpërblimit për një m², nga 3.000 lekë/m² në 108.036 lekë/m². Gjykata, me vendim të formës së prerë, ka vendosur shpërblimin prej 30.000 lekë/m², pra, në një masë të konsiderueshme shumë herë më të vogël nga ajo e kërkuar prej paditësve.

¹⁸ Shihni vendimin nr. ***, datë 17.2.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e ILDKPKI-së.

Në përfundim, pasi u vërtetua se: (i) gjatë proceseve gjyqësore nuk janë shkelur procedurat ligjore; (ii) subjekti dhe nëna e tij nuk janë favorizuar për shkak të influencës apo konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit si gjyqtar, Komisioni krijoi bindjen se, shuma prej 19.000.000 lekësh, deklaruar nga subjekti në deklaratën “Vetting”, është përfituar në mënyrë të ligjshme prej tyre.

2.3 Nga deklaratimet periodike, rezultoi se, kjo depozitë është deklaruar saktësisht në deklarinimin për vitin 2013, si vijon:

i) Në numrin e përbashkët të llogarisë *** (K., V., V., S., Dhimitër Lara dhe K. Ll.), “Banka Credit Agricole” (“Banka Amerikane e Investimeve”), në datën 28.5.2013, është shtuar 1/10 e shumës 108.000.000 lekë, prej pasurisë truall me sip. 3.600 m² në bashkëpronësi, nga shpronësimi me VKM-në nr. 855, datë 13.12.2006, të Këshillit të Ministrave, për vlerën 30.000 lekë/m² me vendim gjyqësor nr. ***, datë 17.2.2012 nga Autoriteti Portual Durrës.

ii) Transferim në numrin e llogarisë *** në “Raiffeisen Bank”, datë 3.6.2013, të shumës 21.600.000 lekë (në bashkëpronësi më nënën e subjektit, znj. S. L.) sipas pjesëtimit vullnetar të bashkëpronarëve K., V., V., S., Dhimitër Lara dhe K. Ll.

Nga verifikimet rezultoi se, nuk ka pasaktësi në deklarime dhe se deklaratimet e subjektit përputhen tërësisht me dokumentet e administruara.

3. Likuiditete në llogarinë bankare rrjedhëse nr. *** në “BKT”, krijuar si mbetje nga interesi i depozitave bankare *rekord 7 vjet*, e shumës gjithsej 19.000.000 lekë, me numra reference ***, *** dhe ***, në vlerën 743.489 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

Gjatë hetimit administrativ “BKT”-ja¹⁹ konfirmoi se në datën 24.1.2017, subjekti i rivlerësimit kishte në llogaritë e tij depozitë, shumën prej 19.000.000 lekësh, dhe në llogarinë e tij rrjedhëse, shumën prej 743.489 lekësh.

Detyrime financiare

Në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar si detyrim financiar huan e pashlyer në shumën prej 1.300.000 lekësh, dhënë pa afat nga tezja e tij, znj. P. Z.

Lidhur me këtë hua, gjatë hetimit administrativ rezultoi se:

i) Me kontratë huaje me shpërblim dhe pa afat²⁰ të datës 17.10.2010, e ndjera P. Z, për të cilën subjekti vërtetoi se është tezja e tij (motra e nënës, znj. S. L.)²¹, i ka dhënë huamarrësit Dhimitër Lara një hua prej 1.300.000 lekësh, e cila ka shërbyer për shlyerjen e një pjese të kredisë në datën 4.8.2006 në “Bankën Popullore”. Kjo hua është me shpërblim në masën prej 4 % dhe pa afat.

¹⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 28.9.2018, nga “BKT”.

²⁰ Shihni kontratë huaje, me shpërblim dhe pa afat në aneksin 4/5 të dosjes së ILDKPKI-së.

²¹ Vërtetuar me certifikatën familjare nr. serie ***, datë lëshimi 4.3.2019, bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit 3, në dosjen e Komisionit.

ii) Znj. P. Z. ka bashkëjetuar në familjen e subjektit të rivlerësimit dhe ka ndërruar jetë në datën 16.9.2017²². Nga verifikimi në sistemin e gjendjes civile të vitit 2014, rezultoi se e ndjera P. Z. ka qenë familjare e vetme dhe me status civil *beqare*.

iii) Me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 21.12.2006, kjo shtetase i ka shitur blerësit B. I. pasurinë e paluajtshme me nr. ***, duke përfituar shumën prej 1.700.000 lekësh, kontratë të cilën subjekti e ka paraqitur pranë ILDKPKI-së.²³

iv) Shuma e huas i ka kaluar subjektit në datën 25.10.2010 në “Societe Generale Albania” me transfertë bankare nga znj. P. Z., me përshkrimin “*kalim fondesh për parapagim kredie*”, vërtetuar nga “Banka Popullore”, e cila konfirmon se në datën 25.10.2010 subjekti i ka shlyer “Bankës Popullore” vlerën prej 2.800.000 lekësh²⁴, nga e cila, shuma prej 1.300.000 lekësh është huaja e marrë nga znj. P. Z., ndërsa shuma prej 1.500.000 lekësh, është marrë hua nga kunati i tij, z. Th. S. (trajtuar më poshtë).

Kjo hua është deklaruar si vijon:

i) Në deklarimin periodik për vitin 2010 është deklaruar “shtim në shumën 1.300.000 lekë”. Në rubrikën “të dhënat konfidenciale”, deklarohet “dhuruar interesi për huan prej 1.300.000 lekësh nga motra e nënës, pra tezja, P. Z.”.

ii) Në deklaratat periodike vjetore për vitet 2011, 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016, subjekti ka deklaruar:

- në rubrikën “shuma e shlyer nga deklarimi i mëparshëm”, shumën prej 52.008 lekësh;
- në “rubrikën gjendja e detyrimit të mbetur e pashlyer”, shumën prej 1.300.000 lekësh;
- në rubrikën “të dhëna konfidenciale”, dhurimin e interesit nga tezja e tij.

iii) Në deklaratën “Vetting”, në “rubrikën përshkrimi i detyrimeve”, deklarohet hua pa afat në shumën prej 1.300.000 lekësh, ende e pashlyer.

Siç shihet në këto deklarime, vihet re një mospërputhje në deklaratimet periodike të subjektit, pasi, nga njëra anë ai ka deklaruar shlyerjen e vlerës prej 52.008 lekësh në çdo vit, dhe nga ana tjetër, ka deklaruar faljen e interesit nga tezja e tij, znj. P. Z. që në vitin 2010 e në vijim.

Për të qartësuar këtë situatë, subjektit të rivlerësimit i është kërkuar të japë sqarime. Në parashtrimet e datës 22.5.2019 dhe deklaratimet gjatë seancës dëgjimore, subjekti u shpreh se nga interesi prej 14 % i “Bankës Popullore” ku ka marrë kredinë, ai i ka paguar tezes së tij, znj. P. Z, vetëm interesin në masën 4 %, (52.008 lekë) duke sqaruar se interesi i mbetur prej 10 %, është pikërisht interesi i deklaruar prej tij që në vitin 2010, si i dhuruar nga huadhënësja. Nisur nga deklaratimet periodike, si dhe nga shpjegimet e subjektit, shuma prej 52.008 lekësh e deklaruar si shlyerje detyrimi prej tij, është përfshirë në analizën financiare si shpenzim për pagim interesash.

²² Shihni deklaratën e interesave privatë periodik/vjetor të vitit 2017, në dosjen e ILDKPKI-së.

²³ Shihni aneksin 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁴ Shihni shkresën nr. ***, datë 19.9.2018, “Societe Generale Albania”.

Të dhëna konfidenciale

Në këtë rubrikë janë deklaruar:

1. Hua bankare, në shumën prej 5.000.000 lekësh, marrë në “Bankën Popullore”, trajtuar më sipër.
2. Hua në shumën prej 1.300.000 lekësh, marrë tezes, znj. P. Z., trajtuar më sipër.
3. Hua në shumën prej 1.500.000 lekësh, marrë kunatit, Th. S., në vitin 2010.

3.1. Lidhur me këtë hua, nga deklaratimet e subjektit rezultoi se:

3.1.a. Në deklaratën “Vetting”, në rubrikën “Të dhëna konfidenciale”, është deklaruar huaja në shumën prej 1.500.000 lekësh nga z. Th. S., nga pasuria e tij e të ardhurave personale në llogarinë e pagës nr. *** në “BKT”, si dhe shlyerja totale e saj deri në muajin tetor të vitit 2013.

3.1.b. Në deklaratat periodike është deklaruar saktësisht huaja dhe shlyerja e saj si vijon:

i) Në deklarinimin periodik për vitin 2010, si shtim në shumën prej 1.500.000 lekësh sipas kontratës së huas së datës 16.10.2010, pa shpërblim dhe me afat tre vjet, me huadhënës Th. S, për shlyerjen e një pjese të huas me “Bankën Popullore” / “Societe General Albania”.

ii) Në Deklaratat Periodike Vjetore për vitet 2011 dhe 2012 është deklaruar shlyerje huaje në shumën prej 516.000 lekësh në secilin vit.

iii) Në deklarinimin periodik për vitin 2013 është deklaruar pakësim (shlyerje detyrimi) në shumën prej 420.000 lekësh për likuidim huaje si dhe, është deklaruar likuidimi total i kësaj huaje.

3.2 Lidhur me këtë detyrim financiar u konstatua se:

i) Me kontratë huaje pa shpërblim dhe me afat shlyerje 3-vjeçar të datës 16.10.2010, shtetasi Th. S., për të cilin subjekti vërtetoi së është kunati i tij (vëllai i bashkëshortes, B. L.)²⁵ i ka dhënë huamarrësit Dhimitër Lara, një hua në shumën prej 1.500.000 lekësh, me qëllim shlyerjen e një pjese të kredisë që subjekti ka në “Bankën Popullore”.

ii) Në datën 22.10.2010 në llogarinë e subjektit në “Societe Generale Albania”, ka transfertë në mbërritje nga llogaria e me nr. *** në “BKT” të z. Th. S për dhënie huaje²⁶ në shumën prej 1.500.000 lekësh me përshkrimin “*për shlyerje kredie*”²⁷.

iii) “BKT”-ja konfirmon se subjekti e ka likuiduar tërësisht huan prej 1.500.000 lekësh, duke kaluar në llogarinë personale të z. Th. S pranë kësaj banke, shumën prej 42.000 lekësh çdo muaj²⁸.

²⁵ Shihni përgjigjen e pyetjes 6 në pyetësin nr. 2, bashkëngjitur certifikatës familjare me datë lëshimi 4.3.2019, si dhe certifikatës së martesës me datë 5.3.2019 në dosjen e Komisionit.

²⁶ Shkresa nr. ***, datë 19.9.2018, nga “Societe Generale Bank”.

²⁷ Kjo shumë, bashkë me shumën e kaluar nga znj. P. Z (1.300.000 lekë) në total 2.800.000 lekë, ka kaluar në datën 25.10.2010 për shlyerje të parakohshme të kredisë.

²⁸ Shihni shkresën e “BKT”-së *** prot., datë 1.10.2018, në dosjen e Komisionit.

iv) Nga analiza financiare ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për të shlyer huan.

3.3. Lidhur me mundësinë financiare të z. Th. S. si person i lidhur, për dhënien e huas rezultoi se, në deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar si burim të huas, llogarinë e pagës së shtetasit Th. S. në “BKT” me nr. ***, për të cilën ka paraqitur pranë ILDKPKI-së²⁹ dokument bankar që vërteton lëvizjet në këtë llogari. Sipas këtij dokumenti, të cilin subjekti e ka vënë edhe në dispozicion të Komisionit në përgjigjet e pyetësorit nr. 4, rezulton se:

i) Për periudhën dhjetor 2007 – tetor 2010, shtetasi Th. S. ka pasur një pagë mujore që varion nga 72.000 lekë deri në 75.690 lekë.

ii) Ditën e kalimit në rrugë bankare të huas prej 1.500.000 lekësh, datë 22.10.2010, gjendja e llogarisë së shtetasit Th. S., ka qenë 1.503.099 lekë.

Me qëllim verifikimin e burimeve të ligjshme për dhënien e huas nga z. Th. S., subjekti është pyetur gjatë procesit të rivlerësimit, i cili, në përgjigjen e tij, i është referuar ekstraktit të shoqërisë “****” sh.p.k., marrë nga QKB-ja,³⁰ sipas të cilit, shoqëria “****” sh.p.k., administrator dhe ortak i vetëm i të cilës është z. Th. S., ka pasur një kapital në vlerën prej 35.000.000 lekësh. Po kështu, subjekti ka përmendur llogarinë e pagës nr. *** të shtetasit Th. S, duke pretenduar se nisur nga këto dy burime, ky shtetas ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për dhënien e huas.

Në lidhje me shoqërinë “****” sh.p.k.

Nga verifikimi (edhe *online*) i ekstraktit historik të shoqërisë “****” sh.p.k., rezultoi së kjo shoqëri me administrator dhe me ortak të vetëm z. Th. S:

i) është themeluar në datën 29.11.1996;

ii) ka pasur një kapital prej 35.000.000,00 lekësh;

iii) në datën 21.12.2010 ka pasur shpërndarje dividendi në shumën prej 2.000.000 lekësh;

iv) nuk vërtetohet shpërndarje dividendi deri në datën 21.10.2010, ditën kur edhe është dhënë huaja.

Në përfundim të hetimeve paraprake, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar me dokumente shkresore që shoqëria “****” sh.p.k., ka shpërndarë dividend përpara dhënies së huas, apo që z. Th. S ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për të cilat janë paguar detyrimet tatimore, për dhënien e huas në shumën prej 1.500.000 lekësh, sipas detyrimit ligjor të parashikuar në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

Në parashtrimet e datës 22.5.2019, si dhe në seancë dëgjimore, subjekti ka paraqitur të njëjtat pretendime në lidhje me të ardhurat ligjore të shtetasit Th. S., si dhe ka vënë në dispozicion shkresën me nr. *** prot., datë 15.5.2019, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, e cila jep informacion për të ardhurat e deklaruara të shoqërisë, shpenzimet e shoqërisë dhe fitimin *neto* pas tatimit që varion nga 1.036.420 lekë në 5.505.878 lekë në vit, për periudhën nga viti 2000 deri në vitin 2010. Për vitin 2010 ky fitim ka qenë në shumën prej 5.324.426 lekësh.

Në lidhje me llogarinë e pagës së shtetasit Th. S.

²⁹ Shihni dosjen e ILDKPKI-së.

³⁰ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3 dhe dokumentet bashkëngjitur.

Në momentin e transferimit të huas, datë 21.10.2010, shtetasi Th. S. ka pasur gjendje në llogarinë e pagës, shumën prej 1.510.000 lekësh, nga të cilat 972.600 lekë janë të ardhura nga paga, si rrjedhim, të ardhura të ligjshme për të cilat janë paguar detyrimet tatimore në kuptim të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe të pikës 3, të nenit D, të Kushtetutës.

Ndërkohë, shuma prej 510.000 lekësh, është transferuar nga znj. A. B. S. në llogari të të vëllait të saj dhe kunatit të subjektit, z. Th. S., në datën 20.10.2010 (një ditë përpara transferimit të huas). Kjo shumë nuk u vërtetua të jetë e ardhur e ligjshme për të cilën janë paguar detyrimet tatimore, ndonëse nga ekstrakti historik i këtij subjekti si person fizik, rezulton se ky subjekt ka ushtruar aktivitet tregtar në momentin e dhënies së huas³¹. Për këtë arsye, Komisioni vlerësoi që shuma prej 510.000 lekësh, të mos konsiderohet si e ardhur e ligjshme për dhënien e huas në shumën prej 1.500.000 lekësh nga ana e z. Th. S.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni çmoi që, për shkak të peshës së ulët specifike në raport dhe në proporcion me të gjitha faktet, rrethanat dhe provat e grumbulluara gjatë hetimit administrativ në lidhje me të tria kriteret e vlerësimit, ky konstatim nuk mund të jetë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

Për arritjen në këtë përfundim, janë marrë në konsideratë edhe faktet si vijojnë:

i) Në dijeni të një fakti të njohur publikisht se shoqëria “****” sh.p.k., ose qendra tregtare *** (***) , ka qenë një qendër tregtare me aktivitet të konsiderueshëm, si dhe në kushtet kur kjo shoqëri ka deklaruar të ardhura, shpenzime dhe ka paguar tatimin për çdo vit kalendarik, është e logjikshme të perceptohet që subjekti nuk ka dyshuar në ligjshmërinë e burimit të shumës së marrë hua prej 1.500.000 lekësh, si dhe në mundësinë financiare të z. Th. S. për dhënien e huas me të ardhura të ligjshme.

ii) Huaja prej 1.500.000 lekësh ka kaluar në rrugë bankare nga llogaria e huadhënësit Th. S., në llogari të huamarrësit Dhimitër Lara dhe po në rrugë bankare, është bërë shlyerja e saj me të ardhura të ligjshme të subjektit të rivlerësimit.

iii) Nuk ka asnjë provë a rrethanë të marrë nga cilido burim i ligjshëm, që të tregojë të dhëna se subjekti ka përfituar në mënyrë të paligjshme shumën prej 510.000 lekësh si pjesë përbërëse e huas prej 1.500.000 lekësh, hua të cilën e ka deklaruar rregullisht që në deklaratën periodike për vitin 2010 e në vijim, duke deklaruar rregullisht gjithashtu edhe shumat e shlyera, si dhe detyrimet pashlyera. Këto të dhëna përputhen me deklaratën “Vetting”, si dhe dokumentet e administruara gjatë hetimit administrativ.

4. Hua prej 7.000.000 lekësh, dhënë kunatit, z. Th. S., pa interes, shlyer e tëra me këste, kësti i fundit më 30.12.2014.

Lidhur me këtë hua, gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se:

i) Kjo hua nuk është deklaruar në deklarin periodik për vitin 2014, pasi rezulton t’i jetë dhënë shtetasi Th. S., në datën 20.6.2014, dhe të jetë shlyer prej tij në datën 30.12.2014, pra, brenda vitit të deklarimit.

ii) Nuk ka asnjë dokument shkresor që të vërtetojë dhënien e huas, por ky fakt vërtetohet pasi nga lëvizjet e llogarisë në “BKT”³² rezulton se në datën 20 qershor 2014, subjekti Dhimitër

³¹ Shihni dokumentin bashkëngjitur në përgjigjet e datës 3.5.2019.

³² Shihni gjendje llogarie nga “BKT”-ja, printuar në datën 17.10.2016, në aneksin ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

Lara ka kaluar në llogari të shtetasit Th. L. shumën prej 7.000.000 lekësh, me përshkrimin *dhënie huaje*.

iii) Lidhur me shlyerjen e huas, “BKT”-ja vërteton shlyerjen e saj nga ana e z. Th. S., sipas deklarimeve të subjektit si vijon:

në datën 14.10.2014 - 1.750.000 lekë
në datën 16.10.2014 - 1.750.000 lekë
në datën 23.10.2014 - 1.500.000 lekë
në datën 30.12.2014 - 2.000.000 lekë
Totali 7.000.000 lekë

iv) Nga analiza financiare rezultoi se subjekti ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për t'i dhënë z. Th. S. huan në shumën prej 7.000.000 lekësh.

Gjatë hetimit administrativ nuk është vërtetuar konflikt interesi me shtetasin Th. S. dhe me shoqërinë “****” sh.p.k., pasi nuk kanë rezultuar çështje në shqyrtim nga ana e subjektit të rivlerësimit, ku palë pjesëmarrëse në procese gjyqësore të kenë qenë këta subjekte³³.

Personi i lidhur, znj. B. L., bashkëshortja e subjektit, e cila është pjesë përbërëse e certifikatës familjare ka plotësuar deklaratën “Vetting” si person i lidhur dhe ka deklaruar llogari rrjedhëse page nr. *** në “Bankën Kombëtare Tregtare” në vlerën prej 35.041 lekësh. Pjesa takuese: 100 %. Kjo llogari është verifikuar nga “BKT”-ja³⁴ dhe është konstatuar se deklarimi është i saktë.

Gjatë hetimit administrativ, nuk janë konstatuar pasuri të tjera në emër të znj. B. L.

Personi i lidhur, z. A. L., djali i subjektit, i cili është pjesë përbërëse e certifikatës familjare ka plotësuar deklaratën “Vetting”, si person i lidhur dhe ka deklaruar:

1. Llogari rrjedhëse *** në “Intesa Sanpaolo Bank”. Vlera: 20.124 lekë. Pjesa takuese: 100 %.
2. Llogari rrjedhëse *** në “Intesa Sanpaolo Bank”. Vlera: 08 lekë. Pjesa takuese: 100 %.
3. Llogari rrjedhëse ***, në “Bankën Kombëtare Tregtare”. Vlera: 0 lekë. Pjesa takuese: 100 %.
4. Llogari rrjedhëse *** Euro, në “Banka Kombëtare Tregtare”. Vlera: 0 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Llogaritë si më sipër, janë verifikuar nga “Intesa Sanpaolo Bank” dhe nga “Banka Kombëtare Tregtare”³⁵ dhe është konstatuar se deklaratimet janë të sakta.

Gjatë hetimit administrativ, nuk janë konstatuar pasuri të tjera në emër të djalit të subjektit, A. L.

³³ Shihni nëntë vërtetimet negative lëshuar nga gjykatat kompetente, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 protokolluar me nr. *** prot., datë 8.3.2019, në dosjen e Komisionit.

³⁴ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 1.10.2019, të “BKT”-së.

³⁵ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 18.9.2019 të “Intesa Sanpaolo Bank”, si dhe shkresën nr. *** prot., datë 1.10.2019, të “BKT”-së, në dosjen e Komisionit.

Personi i lidhur, znj. S. L, nëna e subjektit, e cila është pjesë përbërëse e certifikatës familjare ka plotësuar deklaratën “Vetting”, si person i lidhur dhe ka deklaruar:

Depozitë *rekord* 7 vjet bankare (3 të tilla) në një llogari me nr. *** në “BKT”-së, në emër të djalit, Dhimitër Lara, por edhe për llogari të saj. Vlera: 19.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %. Kjo depozitë është trajtuar më sipër si pasuri e deklaruar edhe nga subjekti i rivlerësimit.

Gjatë hetimit administrativ, nuk janë konstatuar pasuri të tjera në emër të znj. S. L.

Në lidhje me një adresë banimi të deklaruar në përgjigjet e pyetësorit të parë standard të datës 26.6.2018

Gjatë hetimit administrativ u konstatua se në përgjigjet e pyetësorit standard, është deklaruar përdorimi i një apartamenti të ndodhur në ***, Durrës, në pronësi të shtetasve K. K. dhe L. K.

Me qëllim verifikimin e shkakut të përdorimit të këtij apartamenti është pyetur subjekti në lidhje me këtë pasuri dhe në përgjigjes të pyetësorit nr. 2 ai ka sqaruar se këtë apartament ai e ka përdorur në vitin 2007 në muajt korrik-gusht, si dhe në muajin gusht në vitet 2008 – 2014, për shkak të lidhjes së nënës së tij, S. Th. L, me mbesën e saj, L. M. K., një nga bashkëpronaret e pasurisë. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se znj. L. M. K. (B.), është vajza e tezes së tij, U. B. (Z.). Ky fakt, u vërtetua nga sistemi *online* i Zyrës së Gjendjes Civile.

Sqarimet e subjektit përputhen me dokumentet e vëna në dispozicion, si vijojnë:

- i) certifikatë për vërtetim pronësie lëshuar nga ZVRPP-ja Durrës për pasurinë nr. ***, me sip 76 m² në ***, në emër të K. M. K.;
- ii) certifikatë pronësie nr. *** lëshuar nga ZVRPP-ja Durrës, datë 16.1.2018, lëshuar në emër të trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit K. M. K., të L. K. etj³⁶.

Veç sa më sipër, me dokumente shkresore³⁷ nuk u vërtetua që subjekti të këtë pasur çështje në shqyrtim, ku palë pjesëmarrëse në procese gjyqësore ku ai ka ushtruar detyrën, të kenë qenë K. M. K. dhe L. K.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit, është qartësuar shkak i deklarimit të përdorimit të një apartamenti në Durrës, për të cilin nuk ka pasur dyshime apo të dhëna që të tregojnë përfitime të paligjshme nga ana e subjektit të rivlerësimit.

Analizë financiare

Gjatë hetimit administrativ është bërë një analizë e hollësishme financiare e pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, bazuar në gjendjet e likuiditeteve, të ardhurat e ligjshme, shpenzimet, detyrimet financiar të deklaruara nga subjekti, duke i krahasuar ato me informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore. Nga analiza financiare për periudhën e rivlerësimit 2003 – 2016, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën më poshtë, nuk rezulton që subjekti të ketë pasur deklarime të pasakta dhe nuk rezulton që të ketë pasur likuiditete të pajustificuara.

³⁶ Shihni dokumentet bashkangjitur me përgjigjet e pyetësorit nr. 2 në dosjen e Komisionit.

³⁷ Shihni nëntë vërtetime nga gjykatat ku subjekti ka ushtruar funksionet, bashkëngjitur me përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

PËRSHKRIMI/ VITET	PASURI (1)	DETYRIME (2)	PASURI NETO (3=1-2)	TË ARDHURA TË DOKUMENTUARA (4)	SHPENZI ME (5)	Analiza dokumentu ar (4-3-5)
2003	0	0	0	809.087	485.856	323.231
2004	0	0	0	1.277.477	382.856	894.621
2005	557.063	0	557.063	1.564.628	446.228	561.337
2006	3.958.102	4.858.944	-900.843	2.035.437	1.267.485	1.668.794
2007	169.642	-434.052	603.694	1.742.750	815.020	324.036
2008	-7.327	-467.680	460.353	1.534.014	879.825	193.836
2009	-72.809	-479.930	407.121	1.713.877	843.404	463.352
2010	73.699	524.385	-450.686	1.808.633	1.909.823	349.496
2011	-2.004	-685.586	683.582	2.186.877	703.408	799.888
2012	-51.750	-684.404	632.654	1.962.777	714.388	615.735
2013	18.943.328	-1.331.678	20.275.006	23.548.776	2.051.125	1.222.645
2014	1.016.541	0	1.016.541	3.306.240	1.310.297	979.402
2015	-107.666	0	-107.666	2.945.096	1.418.120	1.634.642
2016	-59.987	0	-59.987	4.818.248	1.327.049	3.551.187
TOTAL	24.416.832	1.300.000	23.116.832	51.253.917	14.554.884	13.582.202

Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe të personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare të kërkuara nga: “Societe General Albania Bank”³⁸, “Raiffeisen Bank”³⁹, “Banka Amerikane e Investimeve”⁴⁰, “BKT”⁴¹, “Intesa Sanpaolo Bank”⁴², si dhe gjendjet *cash* të deklaruara nga subjekti⁴³.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

i) Të ardhurat nga pagat e subjektit në: Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës (ndihmësgjyqtar)⁴⁴, Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier⁴⁵, Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë⁴⁶, Shkollën e Magjistraturës⁴⁷, Universiteti Europian i Tiranës⁴⁸ dhe nga shpronësimi⁴⁹;

ii) Të ardhurat nga pagat e bashkëshortes së subjektit në: Drejtorinë Arsimore Rajonale Durrës, shkollën “Naim Frashëri”⁵⁰, shoqërinë “***” sh.p.k.⁵¹;

³⁸ Shkresa nr. ***, datë 19.9.2018, nga “Societe General Albania Bank”.

³⁹ Shkresa nr. *** prot., datë 17.9.2018, nga “Raiffeisen Bank”.

⁴⁰ Shkresa nr. *** prot., datë 26.9.2018, nga “Banka Amerikane e Investimeve”.

⁴¹ Shkresa nr. *** prot., datë 1.10.2018, nga “BKT”-ja.

⁴² Shkresa nr. *** prot., datë 18.9.2018, nga “Intesa Sanpaolo Bank”.

⁴³ Shihni deklaratimet peroidike të çdo viti në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴⁴ Vërtetim nr. *** prot., datë 20.10.2016 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

⁴⁵ Vërtetim pa numër dhe datë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.

⁴⁶ Vërtetim nr. *** prot., datë 23.1.2017 nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda.

⁴⁷ Vërtetim nr. *** prot., datë 20.10.2016 nga Shkolla e Magjistraturës.

⁴⁸ Kontratë përkthimi, datë 22.2.2016, nga UET-ja.

⁴⁹ Vendim gjyqësor nr. ***, datë 17.2.2012.

⁵⁰ Vërtetim për bazën e vlerësueshme nga Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës, shkolla “Naim Frashëri”.

⁵¹ Vërtetim datë 17.10.2016. nga “***” sh.p.k.

- iii) të ardhurat nga pensioni nënës së subjektit⁵²;
- iv) të ardhurat nga interesat bankare⁵³.

c. Shpenzimet, ku përfshihen:

- i) Shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së NJEF (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT-i);
- ii) Shpenzime udhëtimi, për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi *TIMS*. Për përlogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si bazë shpenzimet mesatare të udhëtimeve sipas linjave ajrore, duke filluar nga 180 euro për udhëtim, deri në 300 euro për udhëtim për linjat më të gjata. Ndërsa për shpenzimet e qëndrimit janë llogaritur 50 euro/ditë shpenzim qëndrimi dhe ushqimi.
- iii) Shpenzime arredimi të deklaruara nga subjekti në pyetësorët e dërguar nga Komisioni.
- iv) Shpenzime *interesa dhe principal* për shlyerjen e kredisë financiare me “Bankën Popullore”⁵⁴.

ç. Në vlerat e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, bazuar në kontratat e shitblerjeve të këtyre pasurive⁵⁵.

III. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/206.

Për këtë qëllim, DSIK-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2017, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Dhimitër A. Lara, i deklasifikuar plotësisht me vendim nr. ***, datë 26.12.2018 të KDZH-së, ku është konstatuar se subjekti është i përshtatshëm për të vijuar ushtrimin e detyrës.

Gjatë hetimeve paraprake, nuk ka pasur prova apo të dhëna nga burime të çfarëdo lloji, lidhur me përfshirjen e subjektit në veprimtari korruptive apo në lidhje me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

IV. VLERËSIMI PROFESIONAL

Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit, z. Dhimitër Lara, bazuar në:

1. Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 25.3.2019;

⁵² Vërtetim nr. *** prot., datë 27.10.2016, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

⁵³ Shkresë nr. ***, datë 1.10.2018, nga “BKT”-ja.

⁵⁴ Kontratë nr. ***, datë 4.8.2006, dhe shkresa nr. ***, datë 19.9.2018 nga “Banka Popullore”.

⁵⁵ Shihni kontratat e shitjeve për pasuritë e paluajtshme në dosjen e ILDKPKI-së.

2. Informacionin e marrë nga burime të ligjshme: si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga pesë denoncime të publikut sipas nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, paraqitur pranë Komisionit; ankesat e paraqitura ndaj gjyqtarit Dhimitër Lara pranë KLD-së⁵⁶, si dhe pranë Ministrisë së Drejtësisë⁵⁷;

3. Kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

1. Raporti për analizën e aftësive profesionale kryer nga KLGJ-ja është bazuar në:

- i) formularin e vetëdeklarimit, në tri dokumente ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe në të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- ii) pesë dosjet gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor me shortin e datës 23.11.2018;
- iii) të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.

Në vlerësimin tërësor të aftësive profesionale sipas raportit të KLGJ-së, ka rezultuar si vijon:

Për aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, z. Dhimitër Lara, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ka njohuri për analizën e veprës penale lidhur me fajësinë e autorëve të akuzuar dhe në arsyetim i kushton rëndësi të gjithë elementeve të veprës penale dhe analizës së provave. Është evidentuar në ndonjë rast se në arsyetimin e vendimeve nuk përdoren shprehimisht parimet e përgjithshme të së drejtës, si dhe referenca në jurisprudencën e gjykatave më të larta.

Gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, për gjyqtarin Dhimitër Lara nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e KLD-së. Gjithashtu, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, z. Dhimitër Lara, ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij apo mendimi i pakicës janë të qarta dhe të kuptueshme. Ai përgjithësisht respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe përdor rregullisht të gjitha karakteret e gjuhës shqipe. Struktura e vendimeve të tij është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar.

Përmbajtja e vendimit përfundimtar është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, e cila paraqitet përgjithësisht e thjeshtë dhe e kuptueshme. Niveli i arsyetimit të vendimeve të

⁵⁶ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 19.9.2018, nga KLD-ja.

⁵⁷ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 4.10.2018.

vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Edhe në raste kur ka dalë në pakicë ka bërë analizë ligjore dhe argumentuar votën kundër. Lidhur me të drejtën e palëve për rekurs evidentohen raste kur nuk është disponuar në dispozitivin e vendimit.

Ai i kushton rëndësinë e duhur arsytimit të vendimeve të ndërmjetme, tek të cilat nuk mungon arsytimi dhe përgjithësisht baza ligjore.

Për aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti rivlerësimi, z. Dhimitër Lara, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda Tiranë. Ai ka deklaruar se përgjatë periudhës janar 2014 – dhjetor 2016, në total i janë caktuar 492 çështje, nga të cilat 127 si kryesues dhe për këtë periudhë ka përfunduar 481 çështje, nga të cilat 122 si kryesues. Ai ka mbartur gjithsej 11 çështje të vitit 2016. Rendimenti i përfundimit të çështjeve si kryesues, bazuar në këto të dhëna, është 96 %. Referuar pikës 3, të shkronjës J, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 20 gjykime çështjesh penale. Nga të dhënat statistikore, konstatohet se ngarkesa sasiore për subjektin Lara ka qenë mbi standardin sasior.

Lidhur me kohëzgjatjen e gjykimeve, nga analiza e të dhënave, në raport me standardin kohor 9-mujor për çështjet penale të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, sipas shkronjës “i”, të pikës 5, të Aneksit të Sistemit të Vlerësimit, konstatohet se çështjet janë përfunduar brenda afateve standarde.

Në analizë të të gjitha të dhënave, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, z. Dhimitër Lara, e respekton kohën në gjykim, si një aspekt i rëndësishëm të procesit të rregullt ligjor, duke respektuar afatet standarde të gjykimit të çështjeve, si dhe i kushton rëndësi kohës së arsytimit të vendimeve gjyqësore, gjë që është një aspekt i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, z. Dhimitër Lara, ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore në funksion të zgjidhjes së çështjeve. Nga 13 seancat e vëzhguara, ka rezultuar se në çdo rast subjekti i rivlerësimit është kujdesur që të pandehurit të realizojnë të drejtën e mbrojtjes me avokat në procesin penal. Në katër rastet e gjykimeve të zhvilluara me më shumë se një seancë, ato janë shtyrë brenda afatit procedural kohor 15-ditor të parashikuar në nenin 342/2 të Kodit të Procedurës Penale. Nuk ka pasur seancë të dështuar për shkak të njoftimeve të palëve. Zhvillimi i seancave gjyqësore është bërë gjithnjë në sallë gjykimi, duke e dokumentuar rregullisht këtë veprim, si dhe nuk ka pasur vonesa të seancave, me përjashtim të një seance për shpalljen e vendimit, filluar me 20 minuta vonesë, e cila nuk ka shkaktuar pasoja të dukshme për palët në proces.

Gjyqtari Dhimitër Lara është i qartë për rolin e Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe kryen veprimet e nevojshme procedurale për zgjidhjen e pretendimeve të paraqitura në apelin e palëve.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short është konstatuar se aktet themelore janë të rregullta, të sakta, të plota dhe të administruara në dosje në mënyrë kronologjike. Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën dhe vendin, si dhe veprimet që kryhen në seancë gjyqësore. Gjithashtu, në dosjet gjyqësore të vëzhguara, konstatohet së përgjithësisht dokumentohet shkaku i vonesës së çeljes së seancave gjyqësore.

Për etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Gjyqtari Dhimitër Lara ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 28.3.1994 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2000. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Dhimitër Lara. Gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, për të nuk është paraqitur asnjë ankesë në Inspektoratin e KLD-së. Nga ana tjetër, sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Dhimitër Lara përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

b) Integriteti

Nga verifikimet nuk kanë janë evidentuar të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Dhimitër Lara. Nuk janë konstatuar shkelje të të drejtave të grupeve në nevojë, të cenimit të barazisë gjinore apo të të drejtave të pakicave. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, z. Dhimitër Lara, të mos këtë respektuar rregullat procedurale që lidhen me konceptin e gjykatës së paanshme.

Për aftësitë personale dhe angazhimin profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Nga vëzhgimi i çështjeve të shqyrtuara është konstatuar se komunikimi i subjektit ka qenë i qartë dhe i rregullt. Gjuha e përdorur në seancë gjyqësore është normale. Komunikimi ka qenë në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit, z. Dhimitër Lara, për të bashkëpunuar me kolegët dhe me administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Aftësitë e mira organizative dhe arsyetimi i vendimeve brenda afateve ligjore tregojnë se bashkëpunimi i tij me administratën gjyqësore dhe me kolegët në këtë drejtim ka qenë në nivelin e duhur.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, z. Dhimitër Lara, i ka kushtuar rëndësi formimit akademik dhe angazhimeve profesionale. Pas diplomimit "Jurist" në vitin 1994, ai është diplomuar "Magjistrat gjyqtar" nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2000.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të dhëna, për sa i përket trajnimeve të kryera pranë Shkollës së Magjistraturës, tri vitet e fundit të ushtrimit të detyrës. Gjithashtu, lidhur me trajnimet e tjera jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të dhëna. Nga ana tjetër, gjyqtari ka dëshmuar se është autor i librit/tekstit "Koment mbi Kodin e Procedurës Penale" (pjesa e parë), botimi miratuar me vendimin nr. 1, datë 14.10.2010, nga Këshilli i Botimeve Shkencore i Shkollës së Magjistraturës; autor i punimit "Ekzekutimi", paraqitur në kuadrin e ekspertizës së dhënë në trajnimin vazhdues të gjyqtarëve në Shkollën e Magjistraturës më 3.2.2012; autor i punimit "Pavlefshmëria dhe Papërdorshmëria", paraqitur në kuadrin e ekspertizës së dhënë në trajnimin vazhdues të gjyqtarëve në Shkollën e Magjistraturës më 3.7.2013 - 4.7.2013; autor i librit/tekstit "Koment mbi Kodin e Procedurës Penale" (pjesa e dytë), miratuar botimi me vendimin e datës 3.3.2016 nga Bordi i Redaktorëve i Shkollës së Magjistraturës, në procedurë për botim nga janari i vitit 2015; autor i përkthimit të veprës së prejardhur "Tipare të doktrinës së pastër të së drejtës", nga vepra në italisht "Lineamenti di dottrina pura del diritto" të autorit Hans Kelsen; autor i përkthimit të veprës së prejardhur "Filozofia e së drejtës", nga vepra në italisht "Filosofia del Diritto" të autorëve M. Barberis, G. Bongiovanni, etj., si dhe autor i përkthimit të veprës së prejardhur "Teoria e përgjithshme e së drejtës dhe e shtetit", nga vepra në italisht "Teoria Generale del Diritto e dello Stato" e autorit Hans Kelsen.

Gjatë hetimit administrativ Komisioni, pasi mori në shqyrtim pesë dosjet e përzgjedhura me short, si dhe tri vendimet e zgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, arriti në të njëjtat përfundime si ato të raportit nr. *** prot., datë 25.3.2019, të KLGJ-së, duke vlerësuar pozitivisht subjektin për aftësitë profesionale.

2. Informacioni i marrë nga burime të ligjshme

Si i tillë është konsideruar informacioni i marrë nga:

2.1 Tre vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43, të ligjit nr. 84/2016. Nga analiza e tyre rezultuan të njëjtat konstatime si ato të KLGJ-së në raportin nr. *** prot., datë 25.3.2019.

2.2 Pesë denoncime nga publiku, nga të cilat:

i) Në tre prej tyre, ato të paraqitura nga shtetasit E. L., M. H. dhe V. Ç.⁵⁸ rezultoi se çështjet e denoncuar janë në proces shqyrtimi në Gjykatën e Lartë⁵⁹, ndërkohë që denoncuesit ankohen lidhur me vendimmarrjen, pa referuar asnjë provë e shkelje konkrete nga ana e subjektit;

ii) Në denoncimin e tij, shtetasi E. M.⁶⁰ ngre pretendime ndaj një grupi të madh subjektësh rivlerësimi, duke i konsideruar ata të korrumpuar, ndër të cilët përmendet edhe z. Dhimitër Lara. Nga analiza e denoncimit vihet re se për subjektin e rivlerësimit, z. Dhimitër Lara, nuk ka asnjë

⁵⁸ Shihni denoncimet në dosjen e Komisionit.

⁵⁹ Sipas pikës 2, të nenit E, të Aneksit të Kushtetutës, vlerësimi i aftësisë profesionale nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim.

⁶⁰ Shihni kërkesën nga E. M. protokolluar me nr. *** prot., datë 8.2.2018 nga Komisioni, në dosjen e Komisionit.

provë dhe të dhënë, si dhe nuk referohet asnjë shkelje ligjore/procedurale apo veprim korruptues të kryer prej tij;

iii) Lidhur me denoncimin e shtetasit L. A. Sh.⁶¹, pas verifikimit u konstatua se ky shtetas ka ngritur pretendime për shkelje të ligjit për shkak të paaftësive profesionale dhe korruptim politik të gjyqtarit Dhimitër Lara. Sipas tij, ai ka 20 vjet i akuzuar bashkë me të vëllanë, O. Sh., dhe të tjerë, si themelues dhe anëtar i grupit “***”, duke u akuzuar për krime që nuk i kanë kryer.

Në lidhje me pretendimin për korruptim politik të subjektit të rivlerësimit, z. Dhimitër Lara, pasi u shqyrtuan pretendimet dhe dokumentet e vëna në dispozicion, u konstatua se nuk ka asnjë provë dhe dokument që vërteton këtë pretendim.

Në lidhje me pretendimin mbi aftësitë profesionale, nga analiza e vendimeve gjyqësore të çështjes në fjalë ka rezultuar se:

i) Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. ***, datë 1.7.2008, ka vendosur deklarinim fajtor të 10 të pandehurve për kryerjen e një sërë veprash penale, duke i dënuar përfundimisht si vijon: O. Sh. dhe A. A. me burgim të përjetshëm; G. C. me 25 vjet burgim; N. N. me 24 vjet burgim; R. Sh. me 25 vjet burgim; L. Sh. me 24 vjet burgim; K. S. me 24 vjet burgim; P. N. me 22 vjet burgim; G. Gj. me 10 vjet burgim; D. H. me 23 vjet burgim;

ii) Kundër këtij vendimi prokuroria ka bërë ankim pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda Tiranë, e cila kërkoi ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 1.7.2008, për shkak se të pandehurit O. Sh., A. A. dhe G. C. duhet të deklarohen fajtorë për kryerjen e veprës penale të “akteve terroriste” të parashikuar në nenin 230 të Kodit Penal dhe kërkoi dënimin e tyre me burgim të përjetshëm. Po kështu, është kërkuar të ndryshohet vendimi në lidhje me të pandehurin L. Sh, duke u dënuar me 4 vjet burgim për veprën penale të parashikuar nga neni 109/a i Kodit Penal, si dhe lënia në fuqi e vendimit për pjesët e tjera;

iii) Kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda kanë paraqitur ankim edhe të pandehurit, të cilët kërkuan prishjen e vendimit dhe deklarinim e tyre të pafajshëm.

iv) Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. ***, datë 7.7.2009, me trup gjykues të përbërë nga Dhimitër Lara etj., vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 1.7.2008, të Gjykatës së Shkallës së Parë, lidhur me kualifikimin ligjor, fajësinë e të pandehurve dhe masat e dënimit për disa vepra penale për secilin prej të pandehurve dhe ndryshimin e tij në lidhje me disa vepra të tjera penale. Përfundimisht, sipas këtij vendimi të pandehurit u dënuan si vijon: O. Sh., A. A. dhe G. C. me burgim të përjetshëm; N. N. 24 vjet burgim; R. Sh. 25 vjet burgim; L. Sh. 24 vjet burgim; K. S. 24 vjet burgim; P. N. 17 vjet burgim; G. Gj. 5 vjet burgim; D. H. 23 vjet burgim;

v) Ndaj këtij vendimi është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë nga ana e mbrojtjes së të pandehurve, e cila me vendimin nr. ***, datë 2.7.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke arsyetuar se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPPP-së.

vi) Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. ***, datë 7.11.2011 vendosi shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë 2.7.2010, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si dhe konstatimin e cenimit të së

⁶¹ Shihni denoncim nga L. A. Sh., datë 20.11.2017, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 29.12.2017 dhe denoncim nga L. A. Sh., datë 20.11.2017, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 24.11.2017, në dosjen e Komisionit.

drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosgjykimit brenda një afati të arsyeshëm, si dhe dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

vii) Gjykata e Lartë (Kolegji Penal), me vendimin nr. ***, datë 9.3.2016, ka vlerësuar se Gjykata e Apelit ka gabuar në zbatimin e ligjit procedural dhe atij material penal, duke vendosur prishjen e vendimit nr. ***, datë 7.7.2009, të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në po atë gjykatë me një tjetër trup gjykues.

viii) Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr. ***, datë 13.2.2017, me tjetër trup gjykues, vendosi ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 1.7.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor të Krimeve të Rënda Tiranë dhe deklarimin të pafajshëm të të pandehurve O. Sh, A. A., G. C., N. N., R. Sh., L. Sh., K. S., P. N., G. Gj. dhe D. H. të akuzuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 140, 79/c, 139, 84/a, 141, 136/2, 109/a, e 231 e 28, 77, 186/1, 189/1 dhe 136/2 të Kodit Penal.

Subjektit të rivlerësimit i janë kërkuar sqarime lidhur me konstatimet e vendimit nr. ***, datë 9.3.2016, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Në parashtrimet e datës 22.5.2019, si dhe në seancë dëgjimore, subjekti u shpreh shkurtimisht duke iu referuar Kushtetutës e cila sipas tij, tashmë parashikon emërimin e anëtarëve të Gjykatës së Lartë me propozim të KLGJ-së, të cilëve, si pjesë përbërëse e sistemit gjyqësor, do t'i sigurohen kushtet për të ruajtur pavarësinë dhe paanshmërinë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit profesional, pavarësisht shpjegimeve tepër koncize dhe përgjithësuese të subjektit të rivlerësimit lidhur me çështjen e sipërpërmendur, Komisioni nuk gjeti të dhëna për të arritur në përfundimin se subjekti nuk ka nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale për shkak të vendimmarrjes (unanime) në një çështje ku ai ka qenë pjesë përbërëse e trupit gjykues, çështje e cila është trajtuar gjerësisht sipas ligjit nga organet kompetente të drejtësisë të të gjitha niveleve.

Në arritjen e këtij përfundimi, Komisioni ka marrë në konsideratë edhe faktin se vendimi nr. ***, datë 9.3.2016, i Gjykatës për Krime të Rënda, nuk ka qenë i vetmi vendim që ka vendosur në disfavor të denoncuesit dhe vëllait të tij, për shkak se:

i) Ka qenë fillimisht Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin nr. ***, datë 1.7.2008, e cila ka vendosur deklarimin fajtor të 10 të pandehurve për kryerjen e disa veprave penale me rrezikshmëri të lartë.

ii) Prokuroria pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda Tiranë ka kërkuar ndryshimin e vendimit të sipërpërmendur nr. ***, datë 1.7.2008, duke kërkuar në ndonjë rast rëndimin e pozitës së të pandehurve.

iii) Pasi Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda me vendimin nr. ***, datë 7.7.2009 (ku pjesë e trupit gjykues ka qenë edhe subjekti Dhimitër Lara), ka lënë në fuqi vendimin nr. ***, datë 1.7.2008, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë nga ana e mbrojtjes së të pandehurve. Kjo gjykatë, me vendimin nr. ***, datë 2.7.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit, duke arsyetuar se nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPPP-së.

3. Rivlerësimi i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas kritereve të parashikuara në kreun II, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Në përfundim të procesit të rivlerësimit profesional, bazuar në të gjitha faktet dhe provat e administruara, Komisioni çmoi se:

- subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale, sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016;
- subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative, sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016;
- subjekti i rivlerësimit ka një nivel të lartë të etikës dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016;
- subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.

Në përfundim të procesit, pas propozimit të relatores, sipas së cilës, subjekti duhet të konsiderohet i aftë profesionalisht, bazuar në nenin 44, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni krijoi bindjen së subjekti i rivlerësimit, z. Dhimitër Lara, ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

V. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46, të ligjit nr. 84/2016.

Subjekti ka qenë i gatshëm, duke u treguar tërësisht bashkëpunues me Komisionin, pasi i është përgjigjur me korrektesë pyetjeve brenda afateve të caktuara, gjë që është mbajtur në konsideratë në marrjen e vendimit, në përputhje me nenin 48, të ligjit nr. 84/2016.

VI. SEANCA DËGJIMORE

Në datën 27.5.2019 u zhvillua seanca dëgjimore sipas nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Dhimitër Lara.

Nisur nga rezultatet e hetimit administrativ, lidhur me pasurinë, figurën dhe aftësitë profesionale, Komisioni vlerësoi që procesi i vendimmarrjes në përfundim të procesit të rivlerësimit të bazohet në vlerësimin tërësor të tri kritereve, referuar pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të seancës dëgjimore, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoi subjektin i cili kërkoi konfirmimin në detyrë, pasi dëgjoi relatoren e çështjes, komisionere Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, si dhe pasi administroi dokumentet shkresore, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Dhimitër Lara, si dhe shpalli këtë vendim në datën 17.12.2018, sipas pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

VII. KONKLuzion PËRFUNDIMTAR

1. Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Dhimitër Lara, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59/a të ligjit;

2. Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi së subjekti i rivlerësimit, z. Dhimitër Lara, ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës, sipas nenit 59/b të ligjit;

3. Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, rezultoi së subjekti i rivlerësimit, z. Dhimitër Lara, ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59/c të ligjit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi kreu bisedimet për marrjen e vendimit në praninë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germën “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Dhimitër Lara, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Krimeve të Rënda Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 29.5.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

KRYESUESE
Pamela QIRKO

ANËTAR/RELATOR
Firdes SHULI

ANËTARE NË PAKICË
Etleda ÇIFTJA

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka

MENDIM PAKICE

Si anëtar i trupit gjykues nuk pajtohem me vendimin e shumicës së trupit gjykues për konfirmimin në detyrë të subjekti i rivlerësimit, z. Dhimitër Lara, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, për shkak se subjekti i rivlerësimit nuk arriti sipas meje nivel të besueshëm në rivlerësimin e pasurisë. Ndërsa në lidhje me kriterin e figurës dhe atë të aftësive profesionale bashkohem me mendimin e shumicës së trupit gjykues.

Unë si anëtare në pakicë/kundër vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk duhet të ishte konfirmuar në detyrë, duke mos arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi rezulton se ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me pasurinë e tij, sipas parashikimeve të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, për sa më poshtë:

1. Deklarim i pamjaftueshëm në lidhje me një pjesë të burimit të krijimit të apartamentit të banimit me sip. 66 m² + 25 m² shtesë anësore, në Tiranë.

1.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka në pronësi një apartament banimi me sip. 66 m² + 25 m² shtesë anësore, blerë në shumë 7.500.000 lekë, me adresë: Rr: “****” (***), Tiranë.

1.2 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, si burim krijimi për blerjen e këtij apartamenti, subjekti deklaroi dy burime: (i) shumën 3.400.000 lekë nga shitja e banesës apartament (blerë sipas ligjit për privatizimin e banesave shtetërore të vitit 1993), me sipërfaqe 75 m², regjistruar në zk. ***, vol. ***, f. ***, lagjja ***, Rr. “****”, Durrës, blerëses B. G, sipas kontratës së shitjes nr. ***, datë 29.8.2006; dhe (ii) huanë në shumën 5.000.000 lekë marrë në “Bankën Popullore”, me kontratën nr. ***, datë 4.8.2006.

1.3 Nga hetimi administrativ në lidhje me burimin e shumës 3.400.000 lekë (nga shitja e një apartamenti me sip. 75 m² në Durrës), nga të cilat subjekti ka përdorur vlerën 2.500.000 lekë si burim për blerjen e apartamentit në Tiranë, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit e ka shitur apartamentin në Durrës me sip. 75 m² në datën 29.8.2006, ndërkohë që apartamenti në Tiranë është blerë dhe është likuiduar shuma 2.500.000 lekë në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitjes në datën 29.7.2006. Pra, subjekti i rivlerësimit i ka përfutur këto të ardhura 1(një) muaj më vonë se blerja e apartamentit në Tiranë.

1.4 Pasi iu kërkuan shpjegime lidhur me faktin që data e shitjes së apartamentit në Durrës është 1(një) muaj më vonë se data e blerjes së apartamentit në Tiranë, subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 2, deklaroi se burimi i shumës prej 2.550.000 lekësh të paguara në momentin e nënshkrimit të kontratës është: (i) akti nxjerrje llogarie nga “Raiffeisen Bank”, i datës 24.7.2006, që ai ka tërhequr *cash* shumën prej 1.200.000 lekësh; dhe (ii) shumën prej 1.350.000 lekësh marrë *cash*, nga bashkëshortja e tij, znj. B. L, prej motrës së saj, znj. A. B. (S.), shumë të cilën ia ka kthyer dorazi në datën 29.8.2006, nga të ardhurat e përfuturara nga shitja e banesës në Durrës.

1.5 Ndërkohë që në deklaratën e interesave periodike vjetore të vitit 2006 (vit kur subjekti ka blerë apartamentin), nuk e ka deklaruar burimin e krijimit të këtij apartamenti.

1.6 Nga përgjigjet që subjekti ka dhënë gjatë hetimit, por dhe nga shpjegimet pas kalimit të barrës së provës, subjektit nuk arriti të provojë bindshëm burimin dhe ligjshmërinë e tij, por përkundrazi, me shpjegimet dhe me provat e dërguara gjatë hetimit dhe seancës dëgjimore, pranon se nuk ka deklaruar burimin e vërtetë në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 në lidhje me burimin e krijimit të këtij apartamenti.

1.7 **Si përfundim:** nga analizimi i deklarimeve në lidhje me burimin e krijimit të shumës prej 2.550.000 lekësh që ka shërbyer për blerjen e këtij apartamenti, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë apartamentin në pronësi në deklaratën “Vetting”, duke mos e deklaruar saktësisht dhe plotësisht burimin e krijimit të kësaj pasurie sipas nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

1.8 Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë në lidhje me burimin e krijimit të blerjes së shtëpisë në Tiranë, sipas ligjit nr. 84/2016, për shumën prej 2.500.000 lekësh.

1.9 Subjekti rivlerësimit ka pasaktësi në deklaramin periodik vjetor të vitit 2006, duke mos e deklaruar burimin e krijimit të këtij apartamenti në Deklaratën Periodike Vjetore sipas parashikimeve ligjore.

Baza ligjore për përfundimin e arritur

1.10 Pikat 1, 2 dhe 5, të nenit D, “Vlerësimi i pasurive”, i Aneksit të Kushtetutës, parashikojnë: “1. *Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklaramit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.* 2. *Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin...* 5. ... *Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.*”

1.11 Pika 1, e nenit 32, e ligji nr. 84/2016, parashikon: “*Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarameve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.*”

1.12 Lidhur me përfundimin e trupit gjykues për pasaktësinë në deklaramin se: “*Kjo pasaktësi nuk ka sjellë asnjë pasojë dhe, si e tillë nuk është mbajtur në konsiderate gjatë vlerësimit përfundimtar të çështjes*”, unë, si anëtar në pakicë/kundër, nuk jam dakord, pasi vlerësoj se mosdeklarami i burimit në Deklaratën Periodike Vjetore të vitit 2006 është provë kryesore, e cila vërteton se subjekti i rivlerësimit nuk është i vërtetë në deklaramin e tij në deklaratën “Vetting”, pasi ai nuk e deklaroi burimin në vitin 2006, e deklaroi burimin në deklaratën “Vetting”, i cili është i ndryshëm nga burimi që deklaroi gjatë pyetësorit. Këto veprime dhe mosveprime të subjektit të marra të gjitha së bashku të krijojnë bindjen se ai ka kryer deklaram të rremë.

Sipas pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016: “*Deklaramet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni...*”

1.13 Lidhur me deklaramin e subjektit në lidhje me mospërputhjet e burimit të krijimit të deklaruar: “*Shkak për këtë ka qenë se në deklaratën e përgjithshme të çdo viti, subjektet duhet të deklarorin ato veprime që kalonin edhe në vitin tjetër. Ai nuk ishte i detyruar të deklaronte shumën që i mori znj. B., të cilën ia ktheu me shumën e përfutuar nga shitja e pasurisë në Durrës pas një muaji. Sipas tij, burimi i krijimit të pasurisë në Tiranë është shitja e apartamentit në Durrës, ndërsa në lidhje me huat e përkohshme, ligji nuk kërkon t’i deklarosh ato brenda vitit.*”, unë, si anëtar në pakicë/kundër nuk bie dakord, pasi çmoj se subjekti i rivlerësimit, sipas kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, duhet të kishte deklaruar në mënyrë të detajuar çdo burim që kishte shërbyer për blerjen e këtij aseti, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pika 1 dhe 2 të të cilit parashikon se: “1. *Subjektet e rivlerësimit i*

nënshtrohen deklaratën dhe kontrollin të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

2. Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin...”

1.14 Më tej, nëse analizojmë burimin e krijimit që subjekti i rivlerësimit deklaroi në pyetësonin nr. 2: (i) huaja në shumën 1.350.000 lekë nga znj. A. B. (S.); dhe (ii) tërheqja nga llogaria bankare e subjektit të shumës prej 1.200.000 lekësh në datën 24.7.2006, unë, si anëtar pakicë/kundër, **dal në përfundimin se:**

i) subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësës, znj. A. B. (S.), pasi nuk provoi dot me dokumentacion ligjor justifikues se sa ka qenë fitimi i huadhënësës nga qarkullimi i deklaruar, me qëllim që të vlerësohej pastaj nëse janë paguar detyrimet tatimore apo jo, sipas parashikimeve të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, në lidhje me huan e marrë nga znj. A. B. (S.), subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor justifikues këtë marrëdhënie huaje si në marrje, ashtu edhe në dhënie, sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.

Sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.”*

ii) Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për të krijuar shumën prej 1.200.000 lekësh në datën 24.7.2006, kur ai e ka tërhequr nga llogaria e tij. Bazuar në deklaratën vjetore të interesave privatë të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi gjendje *cash* apo depozitë në shumën 557.063 lekë në fund të vitit 2005, sikundër është përfshirë në analizën financiare të vendimit nga ana e shumicës.

Gjithashtu, nëse do të ishte përdorur realisht kjo shumë e tërhequr për pagesën e apartamentit në Tiranë në datën 29.7.2006, atëherë, sikundër subjekti ka deklaruar pakësimin e shumës 3.400.000 lekë, ai duhej të kishte deklaruar dhe pakësimin e shumës 1.200.000 lekë të tërhequra paraprakisht, gjë të cilën nuk e konstatoj. Pra, subjekti, ka pasur gjithashtu pasaktësi tjetër në deklaratën e vitit 2006, pasaktësi e cila përforcon konkluzionin se subjekti nuk ka deklaruar të vërtetën në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

2. Shlyerja pjesore e parakohshme e huas prej 5.000.000 lekësh marrë në “Bankën Popullore”, datë 4.8.2006.

2.1 Me kontratë huaje afatgjatë nr. ***, datë 4.8.2006, z. Dhimitër Lara dhe znj. B. L., kanë marrë nga “Banka Popullore” huanë në shumën 5.000.000 lekë për blerje apartamenti, për 15 vjet, me interes 5 % në vit. Si garanci për shlyerjen e kësaj huaje janë vënë pasuritë me numra *** dhe ***, blerë në datën 29.7.2006, sipas kontratës me kusht kreditimi nr. ***, nga subjekti dhe bashkëshortja e tij.

2.2 Huaja e marrë në “Bankën Popullore” është shlyer pjesërisht kredinë në datën 25.10.2010, në shumën 2.800.000 lekë, shumë e cila është krijuar nga dy hua që subjekti i rivlerësimit ka marrë në vitin 2010, si vijon: (i) hua në shumën 1.300.000 lekë me kontratën e huas me shpërblim dhe pa afat, në datën 17.10.2010, nga e ndjera P. Z. (tezja e subjekti); dhe shumën prej 1.500.000 lekësh nga z. Th. S. (kunati i subjektit).

2.3 Unë, si anëtar në pakicë/kundër, dal në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e krijimit të të ardhurave të huadhënësve për shkak se:

i) Për të ardhurat e znj. P. Z., subjekti dërgoi një kontratë shitblerje nr. ***, datë 21.12.2006, ku kjo shtetase kishte shitur pasurinë e paluajtshme nr. ***, duke përfituar shumë prej 1.700.000 lekësh, por nuk provoi se këto lekë huadhënësja i kishte pasur gjendje dhe nuk i kishte shpenzuar.

Unë vlerësoj se kjo provë është e paplotë për të vërtetuar burimin e të ardhurave të huadhënësës P. Z., si dhe e interpretuar në harmoni me mospërputhjet gjatë deklarimeve vjetore në lidhje me faljen e interesit të kësaj huaje nga viti 2010 e në vijim, si dhe deklarinë të subjektit se huaja nga kjo shtetase është marrë me qëllim të një interesi më të ulët se ai i bankës, të krijojnë bindjen se kjo marrëdhënie dhe nuk mund të ekzistojë. Kështu që, bazuar vetëm në provat që disponon Komisioni dhe në bindjen time të brendshme, çmoj se subjekti i rivlerësimit nuk ka vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësës për shumë prej 1.300.000 lekësh.

ii) Për të ardhurat e ligjshme të huadhënësit tjetër, z. Th. S, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e tij si nga biznesi, ashtu edhe nga të ardhurat personale. Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit, por edhe nga ana e subjektit të rivlerësimit, nuk u vërtetua se huadhënësi Th. S. kishte të ardhura të ligjshme biznesi nga shoqëria “***” sh.p.k., në momentin e dhënies së huas në vitin 2010, pasi nuk rezultoi të kishte shpërndarë dividend/fitim të shoqërisë gjatë kësaj periudhe. Nëse analizojmë të ardhurat personale të shtetasit Th. S., unë dal në të njëjtin konkluzion me shumicën se shuma prej 510.000 lekësh të mos konsiderohet si e ardhur e ligjshme për dhënien e huas në shumë prej 1.500.000 lekësh nga z. Th. S.

Si konkluzion për sa më lart: referuar provave të administruara gjatë hetimit dhe provave të dërguara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nga interpretimi i këtyre provave në harmoni me dokumentacionin tjetër të administruar gjatë hetimit, unë, si anëtar në pakicë/kundër dal në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka burime të ligjshme financiare për të shlyer kredinë para kohe në vitin 2010, në shumë 2.800.000 lekë, siç ai deklaroi.

Në vlerësimin tërësor të çështjes: mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit e pasurisë, si dhe në vlerësimin tërësor të procedurave për këtë kriter, unë, si anëtar në pakicë/kundër, arrij në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në rivlerësimin e pasurisë, por ka bërë deklarinë të pamjaftueshëm në lidhje me kriterin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE: unë, si anëtare në pakicë/kundër, vlerësoj se shumica e trupit gjykues nuk ka vepruar drejt duke konfirmuar në detyrë subjektin e rivlerësimit, pasi ai nuk i ka përmbushur të tria kushtet e pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, konkretisht kushtin e parashikuar në germen “a”, por vetëm dy nga kushtet.

Për arsyet e sipërcituara, sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me kriterin e pasurisë, bazuar në provat që disponon Komisioni dhe në deklarinë e bëra në seancën dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, z. Dhimitër Lara, nuk ka nivel të besueshëm për vlerësimin e pasurisë dhe, për rrjedhojë, krijoj bindjen se shumica nuk duhet të kishte disponuar konfirmimin në detyrë të këtij subjekti, por shkarkimin e tij nga detyra.

ANËTAR/KUNDËR

Etleda Çiftja